



UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS



UETPRESS

FUQIZIMI I TË RINJVE ROM PËRMES ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE DHE EDUKIMIT PËR MEDIAN ALTERNATIVE



ide / ideas

debate / debates

kërkim / research

angazhim / commitment

UET CENTRE / QENDRA UET

Konferencë kombëtare

PROCEEDINGS



Fakulteti i Shkencave Sociale të Aplikuara
Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike

KONFERENCË KOMBËTARE
**FUQIZIMI I TË RINJVE ROM PËRMES
ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE DHE EDUKIMIT
PËR MEDIAN ALTERNATIVE**

Komunikimi dhe gjithëpërfshirja – Mediat e ‘mëdha’ dhe grupet e ‘vogla’

Proceedings

Tiranë, shkurt 2016



Titulli i librit: **KONFERENCË KOMBËTARE. "FUQIZIMI I TË RINJVE ROM PËRMES ZHVILLIMIT TË KAPACITETEVE DHE EDUKIMIT PËR MEDIAN ALTERNATIVE".**
Komunikimi dhe gjithëpërfshirja – Mediat e 'mëdha' dhe grupet e 'vogla'. PROCEEDINGS

Autori: Universiteti Europian i Tiranës. Fakulteti i Shkencave Sociale të Aplikuara
Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve Publike

Art grafik: Besnik **FRASHNI**

Libri është pjesë e kolanës "ACTA SCIENTIARUM".

© 2016 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar

"Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

uetpress@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-190-40-6

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
"UET Press" është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, shkurt 2016

P Ë R M B A J T J A

- 1 Hyrje
Blerjana Bino, PhD (c)
- 3 Përfshirja e grupeve të skajuara në edukimin zyrtar
Dr. Çlirim Duro
- 4 Media dhe roli i saj në ndërtimin e imazhit
Ervis Iljazaj, PhD
- 9 Diskriminimi nën-rrogos: Komunikimi politik dhe përdorimi i stereotipeve negative
Elvin Gjevori, PhD
- 13 Paraqitjet e një vendi të vogël dhe të largët në një media të madhe amerikane. Rasti i shqipërisë dhe vendeve ballkanike përballë mediave të mëdha perëndimore
Dr. Belina Budini
- 19 Mediat dhe “grupet e pazëshme” në Shqipëri
Gilman Bakalli, PhD
- 23 Is the new media new?
Alfred Lela, PhD (c)
- 26 Funkzioni i mediave të reja në promovimin e “grupeve të vogla”
Lorena Licenji, PhD
- 31 Fuqizimi i të rinjve rom përmes medias alternative
Blerjana Bino, PhD (c)

- 13.30 -14.00 Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 14.00 -14.15 Mirëseardhja – Prezantim i gjetjeve të projektit dhe folësve
Dokt. Blerjana Bino, Drejtor Ekzekutiv, Qendra UET
- 14.15 – 14.30 Fondacioni ABC dhe mbështetja e grupeve të skajuara
Z. Sabina Juka, Ekspert Projekti, Fondacioni ABC
- 14.30 - 14.50 – “Fuqizimi i të rinjve Rom përmes medias alternative”
Znj. Xhesika Korra, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)
- 14.50 – 15.10 “Paraqitjet e një vendi të vogël dhe të largët në një media të madhe amerikane. Rasti i Shqipërisë dhe vendeve ballkanike përballë mediave të mëdha perëndimore”
Dr. Belina Budini, Përgjegjëse e Departamentit të Marrëdhënieve Publike dhe Komunikim, UET
- 15.10 - 15.25 “Sfidat dhe mundësitë në fuqizimin e të rinjve Rom në Media”
Z. Mito Kudaka, Korpusi i Paqes
- 15.25 - 15.45 “Perfaqësimi i Komunitetit Rom në Media dhe çështje të demokracisë dhe të drejtave të njeriut”
Z. Bledar Taho, Drejtor Ekzekutiv, IRCA
- 15:45 – 16:10 “Media dhe përfshirja e diversiteteve”
Ervis Iljazaj, PhD, Lektor, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, UET
- 16.10 – 16.30 “Diskriminimi nën-rrogos: Komunikimi Politik dhe Përdorimi i Stereotipeve Negative”
Elvin Gjevori, PhD, Lektor, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, UET
- 16.30 – 16.50 “Mediat dhe ‘grupet e pazëshme’ në Shqipëri”
Gilman Bakalli, PhD, Lektor, Departamenti i Marrëdhënieve Publike dhe Komunikim, UET
- 16.50-17.00 Prezantimi i “ KANXURA Radio”
Z. Xheksan Çela, Drejtues i Projektit: Radio e Komunitetit Rom
- 17.00-17.20 “Përfshirja e grupeve të skajuara në edukimin zyrtar”
Dr. Çlirim Duro, Lektor, Fakulteti Juridik, UET
- 17.20-17.40 “Funksioni i mediave të reja në promovimin e grupeve të vogla”
Lorena Licenji, PhD, Lektor, Departament i Komunikim, Marrëdhënie Publike, UET
- 17.40 – 18.00 “A është media e re në të vërtetë e re?” – “Is the new media new?”
Alfred Lela, PhD (c) Lektor, Departament i Komunikim, Marrëdhënie Publike, UET
- 18.00 – 18.10 Shfaqja e Pod-Cast “Të rinjtë Rom dhe trajnimi për aftësimin për median alternative”
- 18.10 – 19.00 Diskutime

Hyrje

BLERJANA BINO, PhD (c)

Drejtor Ekzekutiv, Qendra UET

Lektore, Departamenti i Komunikimit dhe Marredhenie Publike, UET



Qendra UET në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri si edhe me mbështetjen e Fondacionit ABC organizojnë konferencën “Fuqizimi i të rinjve Rom përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe edukimit për median alternative”. Në konferencë prezantohen gjetjet e studimit në kuadër të projektit në fjalë i cili adreson një nga sfidat kryesore të gjithë përfshirjes shoqërore të grupeve të skajuar, por duke u ndalur në një dimension më pak të trajtuar sikurse është nevoja për të krijuar dhe zhvilluar hapësira komunikuese pjesëmarrëse alternative për këto grupe. Së dyti, konferenca sjell së bashku kërkues të shkencave politike dhe komunikimit për të diskutuar rreth medias dhe grupeve të skajuar. Për më tepër, konferenca vendos në qendër të rinjtë Rom dhe prezanton gjetjet e projektit sa i takon fuqizimit të rinjve Rom përmes medias alternative. Për më tepër në konferencë do të prezantohet edhe ‘KANXURA Radio’, Radio e Komunitetit Rom si një tregues konkret i rolit të medias alternative për krijimin e hapësirave komunikuese dhe pjesëmarrëse për grupet e skajuar.

Konferenca prezanton arritjet kryesore të projektit për fuqizimin e të rinjve rom përmes medias alternative sikurse ishin: një analizë vlerësuese e situatës rreth kompetencave

dhe hapësirave mediatike të komunitetit rom; ngritja e një rrjeti bashkëpunëtorësh për të zhvilluar iniciative që kontribuojnë në fuqizimin e të rinjve përmes edukimit dhe lidërshipt; trajnimi i të rinjve rom dhe jo rom rreth komunikimit masiv, mediave alternative, menaxhimit të projekteve mediatike, advokimit dhe aktivizimit përmes medias alternative.

Qendra UET ka si një ndër shtyllat e programit të saj çështjet e gjithë përfshirjes shoqërore dhe të drejtat e liritë e njeriut dhe në këtë kuadër ka zhvilluar disa iniciativa me fokus komunitetin rom dhe një ndër më të suksesshmet është pikërisht ky program trajnues dhe mbështetës për të rinjtë rom për ndërtimin e radios së tyre të komunitetit. Unë e vlerësoj këtë si një alternativë përkundër mediave të rrjedhës dominuese, të cilat ofrojnë pak ose aspak hapësira komunikuese pjesëmarrëse për këtë komunitet”

Qendra UET dhe IRCA, mbështetur nga ABC, arritën të zhvillojnë kapacitetet e të rinjve të përfshirë për të përdorur mediat e reja, alternative, sociale për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve, politik bërësve dhe aktorëve të tjerë rreth kauzave të gjithë përfshirjes dhe luftës ndaj diskriminimit.

Konferenca u përmbyll me prezantimin e radios online të ngritur nga të rinjtë rom pranë IRCA, Radio Kanxura. Ngritja e kësaj radio është dhe pika kulmore e përmbylljes së këtij projekti, si një hapësirë komunikuese alternative dhe pjesëmarrëse

drejt gjithë përfshirjes shoqërore. Radio Kanxura, përmes hapësirës komunikuese të lirë dhe pjesëmarrëse për të rinjtë rom, do të mundësojë fuqizimin e identitetit të komunitetit rom dhe ndërtimin e një shoqërie të hapur e gjithëpërfshirëse.

Përfshirja e grupeve të skajuar në edukimin zyrtar

Dr. ÇLIRIM DURO

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti juridik, Departamenti e Drejtë Publike, Lektor



ABSTRAKT

Shqipëria është një shtet që cilësohet si një vend i tolerancës dhe i respektimit të të drejtave të gjithë qytetarëve pavarësisht dallimeve që mund të kemi. Ky është një mendim standard që e merr në çdo institucion, zyrtar apo individ që mund ta pyesësh për gjendjen dhe statusin e të drejtave të minoriteteve të të gjitha kategorive (etnike dhe kulturore) në vendin tonë. Situata është disi më ndryshe, kur shohim një element të vecantë sic është edukimi i grupeve skajore në sistemin tonë arsimor. Nga vështrimi

me shumë kujdes i situatës, do shohim se gjendja është jo dhe aq pozitive sa ne mund të mendojmë dhe kjo për dy arsye të rëndësishme. E para është mos vëmendja e duhur që institucionet shtetërore të arsimit i kushtojnë këtyre grupeve skajore. E dyta po aq e rëndësishme është dhe mos përfshirja e vetë këtyre grupeve të interesuara, në edukimin që vetë institucionet shtetërore ofrojnë. Në këtë kumtesë do të trajtojmë të ndara dhe me shembuj sinjifikativ, por sidomos edhe me shembuj në aspektin statistikor të përfshirjes së këtyre grupeve, në sistemin e edukimit zyrtar të Republikës së Shqipërisë.

Media dhe roli i saj në ndërtimin e imazhit

ERVIS ILJAZAJ, PhD

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit,
Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, Lektor



ABSTRAKT

Sa pasqyrimi i realitetit në mediat shqiptare reflekton kompleksitetin e shoqërisë dhe si ndikon ajo në pasqyrimin e realitetit dhe ndërtimin e imazhit për grupe të caktuara shoqërore? Kjo është pyetja kryesore, e cila ngrihet në këtë studim që ka si objektiv të studiojë, se cilat kategori shoqërore apo realitete të ndryshme janë protagonist të lajmeve në vëndin tonë. Në këtë kumtesë do të bazohemi kryesisht në përfaqësimin e grupeve të ndryshme në hapësirën mediatike dhe mënyrën se si ato paraqiten. Studimi ka si qëllim të masë peshën, që grupe të ndryshme si minoritet etnike, njezëit me orientim seksual të ndryshëm apo me aftësi të kufizuara kanë në shoqërinë shqiptare dhe sa përkon kjo me hapësirën mediatike që i kushtohet atyre.

Fjalë kyç: Media, Imazhi, Komuniteti Rom, Stereotipet

HYRJE

Ligjërimet në masmedia, imazhet dhe tekstet e shkruara kanë një rol thelbësor në përcaktimin e çështjeve kryesore si dhe perceptimin e vetes

dhe botës që na rrethon. Kur ndryshimet sociale ndodhin kaq shpejt, njerëzit shpeshherë e përdorin median për të kuptuar evolucionin kontekstual socio-kulturor. Media prodhon dhe jep informacione, analiza, vlera sociale që influencojnë zakonet për sa i përket ndryshimeve raciale, seksuale, etnike, dhe fetare. Marrëdhëniet e pushtetit strukturojnë procesin se si njerëzit perceptojnë botën dhe kufizojnë kategoritë sociale. Mas media ka një rol të rëndësishëm në krijimin e një fryme harmonie midis kategorive të ndryshme socio-kulturore si dhe në pranimin e diversiteteve në jetën komunitare, ekonomike dhe sociale. Në shoqëritë globale multikulturore, kultura, media dhe komunikimi janë në mënyrë të pashmangshme të lidhura bashkë. Sot jetojmë në një ambient mediatik kulturor ku mass media ka një rol thelbësor dhe shpesh decisiv në përmisimin ose shkatërimin e imazhit të njerëzve, vëndeve apo feve të ndryshme. Të gjitha këto qëllime arrihen vetëm nëpërmjet përfaqësimit të drejtë në mediat e shkruara apo vizive të kategorive të ndryshme shoqërore dhe kulturore. Është e pamundur një përfaqësim politik i të gjithave shtresave shoqërore nëse nuk fillojmë nga përfaqësimi i tyre në mass media duke qënë se në demokraci ka një rol të

rëndësishëm opinioni public dhe perceptimi i tij në qeversjen e shoqërisë në të gjitha nivelet.

SITUATA AKTUALE. MEDIA DHE KOMUNITETI ROM

Gazetaria ka zhvilluar gjithmonë një rol thelbësor në zhvillimin e jetës demokratike, duke denoncuar abuzimet mbi të drejtat e njeriut kudo që ato shfaqen duke promovuar respektimin e tyre nëse demonstronë pavarësi nga pushtetet dominuese që mohojnë këto të drejta. Në vitet e fundit, informacioni që vjen nga masmedia ka qenë një faktor i rëndësishëm, i cili influencon interpretimin e realitetit, duke marrë një përgjegjësi për shkak të impaktit politik, social dhe kulturor që informacionet kanë në një botë globale. Të gjitha diskutimet mbi përgjigjësinë e mediave në publikimin e mesazheve diskriminuese vendosin në rrezik lirinë e informacionit. Për këtë arsye, principet etike në industrinë e informacionit duhet të bazohen në kodet formale por edhe mbi një ndërgjegje të fortë për pasojat që mund të ketë një informacion jo korrekt dhe i bazuar në stereotipe.

Kronikat që kanë të bëjnë me komunitetet e ndryshme dhe mbi të gjitha me atë rom shpesh herë tentojnë të jenë thjeshtëzuese, vetëm në disa raste komunitet e paragjykuara dalin në një dritë positive nga lajmet e cdo dite. Ky imazh negativ për këto komunitete dhe në vecanti për atë rom është i shpërndarë në shumë vende europiane dhe jo vetëm në Shqipëri. Një imazh parcial dhe i paraqitur në mënyrë false të një sjellje individuale, mund lehtësisht të kontribuojë në krijimin e një sjelljeje negative sociale kundrejt këtyre kategorive, me një impakt të fortë mbi imazhin kolektiv të një populli. Kështu që informacionet stereotip që shpërndahen mund të influencojnë mënyrën se si gazetarët ndërtojnë historitë duke zgjatur në këtë mënyrë imazhin kriminal të një minorance. Stereotipet anti-rom shfaqen në media në formën e kategorive sociale dhe etiketave negative si: nomad, hajdut, shfrytëzues të minoreneve, etj. Pasqyrimi fals i realitetit, tituj dhe kronika skandaloze mund të ushqejnë

sentimente dhe sjellje diskriminuese ndaj këtij komuniteti. Ky informacion jo i vërtet është kryesisht përgjegjës në rritjen e një atmosfere intolerance në ditët e sotme.

Stigmatizimi i popullsisë rom mund të rritet ose frenohet nga roli që zhvillon media. Është e rëndësishme të theksojmë se paragjykimet kundrejt popullsisë rom dhe përjashtimi i tyre nga shoqëria bazohet mbi faktor strukturor dhe historik të cilat nuk mund të zgjidhen me një pasqyrim mediatik më të mirë. Megjithatë, një informacion i kujdesshëm mund të ndihmojë në kalimin e stereotipave dhe uljen e 'ankthit' kolektiv. Një hap tjetër i rëndësishëm është ai i dënimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe mbështetjen e politikave gjithë përfshirësë. Mediat kanë një rol të rëndësishëm për të zhvilluar duke evituar të trajtojnë fenomene eskuzivisht që ka të bëjë me një tragjedi dhe meriton një supertitull, të cilat janë të papërshtashme si politikisht ashtu edhe institucionalisht duke rrezikuar manipulimin emotiv të shoqërisë. Kështu që është e rëndësishme që mediat të promovojnë aktivitetet që parandalojnë diskriminimin, tolerancën dhe bashkëjetesën.

Racizmi kibernetikë, i cili gjithashtu përbën një problem dhe është një fenomen gjithmonë e në rritje duke patur një potencial të madh në shpërndarjen e diskutimeve dhe ideologjisë së urrejtjes, kërkon një vëmendje urgjente nga ana e legjislacionit dhe e politikanëve. Organizmat dhe shoqatat që merren me barazinë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, konstatojnë një numër në rritje të denoncimeve për urrejtje racore në internet, përfshirë këtu material kundër popullsisë rom si dhe paragjykime mbi çdo minorancë tjetër etnike. Në internet racizmi kibernetik shfaqet nëpërmjet shkrimeve të ndryshme, videove, fotove, blogjeve dhe komenteve online. Për këtë arsye ka nevojë për një monitorim të vashdueshëm në hapësirat kibernetike për të evituar urrejtjen racore si dhe përmirësimin e legjislacionit për të mbrojtur këto kategori të marginalizuara nga sulme që janë kundra të drejtave të njeriut. Shpeshherë ka një mungesë njohje të komunitetit rom që ushqen klishet dhe paragjykimet, të cilat ndihmojnë përhapjen e

artikujve në media duke parë këtë komunitet të lidhur gjithmonë me një varferi ekstreme apo jetesën e tyre në natyrë. Përkundrazi shumica e tyre dërgojnë fëmijët në shkollë, punojnë dhe nxjerin fitime me punë të ndershme. Fatkeqësisht pasqyrimi negativ i komunitetit rom egziston jo vetëm në Shqipëri por në të gjitha vëndet e Europës.

Mediat shumë herë në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo prodhojnë lajme që influencojnë përhapjen e ndjenjave kundër komuniteti rom. Për shembull, në rastet kur jepet një lajm që ka të bëjë me një krim, të japësh prejardhjen etnike të autorit nuk ka aspak një qëllim konstruktiv. Edhe pse mund të kuptohet që mediat citojnë grupin etnik kur japin informacione mbi akte dhune, kjo duhet të përbëjë një përjashtim dhe jo të jetë normë. Kronikat e lajmeve shpeshherë përmbajnë informacione të parëndësishme që kanë një efekt negativ mbi disa grupe, të cilat ndikojnë në stigmatizimin e këtyre kategorive. Duhet të kuptojmë, që një sjellje individuale mund t'i ngarkohet një kategorie shoqërore të tërë nëse citohet prejardhje etnike, duke demonizuar në këtë mënyrë një komunitet pa i shtuar asnjë vlerë informacionit.

Ajo që po ndodh të paktën në vëndet europiane me partitë politike të ekstremit të djathtë duke vënë komunitetin rom në shënjestër, si e keqja më e madhe e shoqërisë, është e papranushme dhe jo e vërtetë. Këto parti përhapin ndjenja racore vetëm me qëllimi të marrjes së votave. Të ndodhura në vitet e fundit përballë një krize ekonomike retorika anti-rom është një retorikë fitmiprurëse në aspektin politik, sepse kapitalizon paragjykimet e komuniteteve mazhoritare në këto shtete. Të gjitha këto paragjykime më tej pasqyrohen në mediat kombëtare apo lokale dhe krijojnë një klimë jo tolerante dhe racore ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

INFORMACIONI PA PARAGJYKIME: SI TË SHMANGIM STEREOTIPAT

Raporti OSBE/ODHIR në vitin 2008 vuri në dukje, që në disa shtete mediat publike apo private kanë filluar gradualisht të ndryshojnë mënyrat

sesi paraqesin komunitetin rom apo dhe pakicat e tjera shoqërore duke filluar që nga eliminimi i çfarëdo fjale me kuptim negativ. Gjithashtu, i kushtohet një vëmendje më e madhe eliminimit të paraqitjes së komuniteti rom si një entitet i vetëm dhe homogjen. Megjithëse këto ndryshime pozitive, ky raport në vitin 2014 doli përsëri me disa rekomandime për të inkurajuar median për të demonstruar aspektet pozitive dhe një kuadër më të ekuilibruar për jetën e komunitetit rom, duke ndaluar përdorimin e stereotipeve në përshkrimin e këtij komuniteti, për të evituar diskriminimin dhe paragjykimet. Qëllimi i këtij seksioni është të ofrojë operatorëve të mediave rregulla dhe ide thelbësore të bazuara në kode etike, kode profesionale dhe ligje në mënyrë që të prodhohet një informacion i paanshëm dhe i ekuilibruar për të evituar paragjykimet dhe diskriminimin kundrejt komuniteti rom. Gjithashtu do të paraqesë disa shembuj të projekteve europiane të cilat mund të aplikohen edhe në vëndin tonë për të pasur një ide, se sa është bërë për të përmisuar imazhin e këtij komuniteti. Këto janë disa nga sygjerimet për të evituar stereotipet dhe për të pasqyruar realitetin në mënyrë sa më të kujdesshme. Këto sygjerime janë mbledhur nga burime të ndryshme si kode etike, rekomandime të insitucioneve ndërkombëtare si dhe nga praktikantët më të mira që aplikohen në vende të ndryshme. Përdorimi i një terminologjie të duhur që respekton ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare në mënyrë që tu ofrohet lexuesve dhe spektatorëve një pasqyrim i realitetit sa më i vërtetë i mundshëm.

EVITIMIN E FJALORIT QË STIGMATIZON KATEGORI TË NDRYSHME SHOQËRORE

Evitimin e shpërndarjes të informacioneve jo të sakta, të thjeshtëzuara apo të deformuara. Një shërbim mediatik sipërfaqësor mund të sjell shqetësimin e opinionit publik për shumë çështje sidomos atyre për sa i përket etiketimit të kategorive të ndryshme shoqërore:

- Familjarizimin e opinionit publik me legjislacionin anti-diskriminues;

- Përmbajtja i fakteve;
- Paraqitja e personave si qenie humane dhe jo si përfaqësues të një grupi etnik apo fetar të caktuar;
- Kur është e mundur të konsultohen ekspert apo organizata me një eksperiencë në këto argumenta në mënyrë që ti ofrohet publikut një informacion i qartë, i kuptueshëm që analizon dhe arsyet me të thella të fenomenit që është në diskutim;
- Denoncimin e artikujve diskriminues për të përforcuar besueshmërinë në masmedia;
- Informimi mbi historitë pozitive të komunitetit rom, jo vetëm apsektet që kanë të bëjnë me përjashtimin dhe ilegalitetin;
- Monitorimin e mediave në mënyrë konstante;
- Të dëgjojmë zërin e këtyre kategorive;
- Ndërtimin e një bashkëpunimi midis komunitetit rom dhe shoqërisë civile. Pjesëmarrja është një faktor thelbësor;
- Ti kushtojmë vëmendje diskutimeve të personazheve publike që nxisin lëvizje raciste apo akte ksenofobe, shpërndarja e tyre është veçanërisht e rrezikshme;
- Ti kushtojmë vëmendje imazheve që shfaqen në media të ndryshme. Paraqitja e komunitetit rom si shitës ambulant, kriminel etj. është shumë e rrezikshme në stigmatizimin e kësaj kategorie.

KONKLUZIONE

Një analizë e kujdesshme e sektorit konfirmon, që gazetaria shpesh herë ndihmon në mënyrë të qëllimshme ose jo paragjykimet dhe kundrejt komunitetit rom nëpërmjet mesazheve raciste për shaka të klisheve dhe stereotipave apo si pasojë e përdorimit të një terminologjie jo të duhur. Në raste të tilla, gazetarit i shkelen vlerat deontologjike të profesionit të tij duke na bërë të reflektojmë mbi kufirin e të drejtës së informacionit dhe detyrimit të përgjegjësive kundrejt minorancave. Literatura në këtë fushë na tregon që grupet mbi të cilat krijohen

lehtësisht stereotipe janë kryesisht subjekte të fenomeneve diskriminuese. Të flasësh për komunitetin rom në media në përgjithësi do të thotë ti akuzosh për shumë probleme sociale si dhe problemet që shkaktohen midis kulturave të ndryshme. Kjo ndodh shpesh për shkak të një tendence etnocentrike. Përfaqësimi i grupeve shoqërore të ndryshme nuk bëhet nëpërmjet opinioneve por nëpërmjet një njohje sistematike dhe organizative të realitetit. Një karakteristikë tjetër për sa i përket pasqyrimit të këtij komuniteti është se lajmet, që shfaqen për të, janë në një formë të shkurtër, pa një analizë të vërtet për shkaqet apo kontekstin e zhvillimit të këtyre ngjarjeve. Në përgjithësi është më e lehtë të krijosh artikuj që konfirmojnë stereotipet të cilat egzistojnë se sa të shkosh kundra tendencës.

Në përfundim, të drejtat thelbësore të dinjitetit dhe barazisë për të gjithë, pavarësisht etnisë kërkojnë respekt dhe një mbrojtje të pakushtëzuar. Informacioni publik, në vecanti, duhet të kujtohet për rolin e madh të përgjegjësive që kanë në këto raste. Asnjë nuk është i lirë të çenjë dinjitetin e një komuniteti nëpërmjet propagandës raciste, me qëllim apo jo qoftë ajo. Një integritet i vërtet do të ndodhte vetëm duke konsideruar të ndryshmen si një burim dhe një pasuri në kontaktet ndërmjet grupeve etnike. Për këtë arsye, në mediat vizive apo të shkruara duhet të reflektohet prospektiva multi-etnike për të ndihmuar kohezionin shoqëror. Pasqyrimi stileve të jetës të ndryshme si rezultat i diferencave kulturore është thelbësore në ndërtimin e një shoqërie moderne dhe gjithëpërfshirëse.

REFERENCAT

- Di Giovanni E. (2010), How to Empower Gypsies? An Ethnographic Study. In J. Chapple(ed) Boundaries: Dichotomies of Keeping In and Keeping Out, Inter-Disciplinary Press, Oxford, United Kingdom.
- Lavanco G., Novara C., Romano F., and Di Giovanni E. (2008), Cohabiting in Multiethnic Community: Forms, Representations and Images of the Diversity. International Journal of Humanities and Social Sciences.
- Martins H. (2010), Living between Countries, Living between Nature and Society: Anthropological

Remarks on National and Cultural Identities.
In Chapple J. (ed), *Boundaries. Dichotomies of Keeping In and Keeping Out*, Oxford, Inter-Disciplinary Press
Morris R. (2000), *Gypsies, Travellers and the Media: Press regulation and racism in the UK*. *Communications Law*, Vol. 5, No. 6

Sigona N. (2009), *I rom nell'Europa neoliberale: tra antiziganismo e povertà*. *Jura Gentium. Rivista di filosofia del diritto internazionale e della politica globale*, (V) 1.
Sigona N. and Treheran N. (2009), (eds). *Romani Politics in Contemporary Europe*. London, Palgrave MacMillan.

Diskriminimi nën-rrogos: Komunikimi politik dhe përdorimi i stereotipeve negative

ELVIN GJEVORI, PhD

Universiteti Europian i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale të Aplikuara, Lektor



ABSTRAKT

Në shoqëritë moderne, mediat e mëdha, përveç përçimit të informacionit mbi debatin politik, janë instrumentale në formësimin e opinionit publik sidomos përsa i përket të drejtave të grupeve të margjinalizuara. Si rrjedhojë, studimet kryesore në këtë fushë kanë analizuar mbulimin direkt që mediat i bëjnë diskursit politik mbi grupet e margjinalizuara. Ky artikull pretendon që në kohët moderne, diskriminimi (diskursiv) direkt, është gjithmonë e më i papranueshëm e si rrjedhojë ai është zëvendësuar me diskriminimin indirekt ku grupet e margjinalizuara përdoren si shembuj negativë në diskursin politik. Ky lloj diskursi mundëson vazhdimin e paragjyqimeve dhe përçimin e tyre ndër breza. Për të testuar këtë argument, artikulli analizoi një sërë debatesh parlamentare në Shqipëri nga 1992 në 2009 për të parë nëse dhe si paragjykimet dhe stereotipet etno-kulturore u përdorën në diskursin politik në Shqipëri. Studimi, konkludon që këto stereotipe vazhdojnë të përdoren si shembuj negativë në Shqipëri dhe sugjeron që për të patur një shoqëri me gjithëpërfshirëse, i tërë diskursi politik duhet bërë më i ndjeshëm dhe i vetëdijshëm ndaj grupeve të margjinalizuara.

HYRJJE

Disa muaj më parë, në Amerikë, flamuri i shteteve të konfederatës që luftuan kundër qeverisë federale në mbajtje të skllavërisë u bë objekt debati në Karolinën e Jugut pasi një supremacist i bardhë i veshur me flamurin e Konfederatës hapi zjarr në një kishë Afro-Amerikane duke vlarë njerëz të pafajshëm (Jamieson 2015). Menjëherë miliona njerëz kërkuan heqjen e flamurit të konfederatës nga parlamenti shtetëror pasi e shihnin si simbol urrejtje dhe dasie raciale. Mbështetësit e flamurit e shikonin atë thjesht si një simbol që përkujtonte të rënët e luftës. Qartësisht, pas heqjes së diskriminimit institucional/ligjor, debati mbi diskriminimin - të paktën në botën perëndimore - ka kaluar në fushën e komunikimit dhe simbolikës. Ky transformim, e bën racizmin një nga faktet sociale më të vështira për t'u studiuar (Smitherman and van Dijk 1988). Të rrallë janë njerëzit që vetë-identifikohen publikisht si racistë. Shpesh herë racizmi, sic tregon shembulli i Karolinës së Jugut, kamuflohet si mbrojtje e traditave apo betejë ndaj globalizmit që shkatërron kulturat dhe traditat lokale. Gjithësesi, shpesh-herë mbrojtja e të vjetrës

mbron edhe racizmat e ngulitura thellë në strukturën shoqërore (Minow 1990). Prandaj, për të analizuar racizmin e kamufluar modern, dhe diskriminimin e pa shprehur të shoqërive tona, është e nevojshme që të analizohen mënyrat se si komunikimi modern politik përçon mesazhet tashmë të papranueshme në mënyra më të pranueshme.

Për këtë arsye ky artikull analizon se si në parlamentin shqiptar në dabate politike të palidhura me ceshtje diskriminimi apo kohezioni social përçohen mesazhe diskriminuese që përforcojnë paragjykimet ekzistuese dhe ulin vlerën e deklaratave politike në favor të gjithë-përfshirjes. Specifikisht, ky artikull analizon debatet parlamentare mbi reformën në forcat e armatosura për të identifikuar mekanizmat nëpërmejt të cilave ligjëvënësit, shpesh në mënyrë të pavetëdijshme, përçojnë mesazhe diskriminuese.

DEMOKRACIA, QYTETARIA DHE PËRSHIFRJA

Ashtu si me aq shumë në politikë, komunikimi politik filloi të analizohet nga grekët e lashtë nëpërmjet idesë së tyre të *polis*, dhe specifikisht demokracisë në qytet-shtetin e Athinës (Perloff 2014). Një arsye për interesin e vazhdueshëm në Athinë ndaj komunikimit politik është se ato përbënin shembullin e parë të një sistemi politik ku fjala kishte peshë mbi vendimet politike. Idetë e diskutuara nga qytetarët më të shquar të Athinës - në veçanti Aristoteli dhe Platoni - kanë frymëzuar zhvillimin e teorisë së komunikimit politik siç tregohet nga sasia e jashtëzakonshme e vëmendjes ende përkushtuar filozofisë greke në literaturë. Trashëgimia e Athinës, edhe pse është kritikuar në mënyrë rutinore, është e pamohueshme. Edhe pse ne duhet të kujtojmë se Athina nuk ishte e vetme në angazhimin e saj ndaj demokracisë dhe varieteteve të këtij sistemi, pasi ai lulëzoi në të gjithë Greqinë e lashtë, demokracia Athinase është më e njohur për ne, dhe kështu do të jetë baza e këtij diskutimi.

Aristoteli fillon nga premiset që qenia njerëzore është një «kafshë politike», që do të thotë që jetojnë së bashku në komunitete (Miller

2011). Aristoteli e përkufizon një komunitet si të përbërë nga njerëzit me vlera të përbashkëta të cilët përpigën së bashku për të krijuar komunitetin ideal dhe për të jetuar një jetë të vlefshme (Yack 1985). Prandaj lumturia individuale është presupozuar si një shqetësim i përbashkët për ata që jetojnë në komunitet. Nga ky presupozim, grekët konkluduan që edhe pushteti politik, si derivat i vullnetit të polisit, duhet të merret me lumturinë e qytetarëve. Si rrjedhojë, grekët e lashtë riformuan nocionin e legjitimitetit, ku ushtrimi i pushtetit është i bazuar as në forcë ushtarake e as në kërcënimin e forcës; legjitimiteti i vërtetë rrjedh nga pranimi i qartë nga ana e qytetarëve se qeveria ka të drejtë për të qeverisur e nisur nga shqetësimi për lumturinë e tyre (Coicaud 2002).

Deri këtu cdo gjë është mirë, por përkufizimi i grekëve mbi qytetarinë ishte tejet i kufizuar. Përkufizimi i tyre bënte të mundur që një popullsi e konsiderueshme e qyteteve, sidomos meshkujt nën moshën 20 vjec, skllevërit, dhe emigrantët (të gjithë ata që ishin vendosur në Athinë, duke përfshirë edhe ato të shteteve të tjera greke, pavarësisht se sa kohë më parë kishin emigruar) nuk konsideroheshin qytetarë. Këto grupe ishin jashtë polisit, edhe pavarësisht se ata jetonin dhe punonin aty, at nuk ishin qytetarë e nuk kishin të drejta. Në këtë mënyrë, demokracia greke apo athinase u bazua në pabarazinë dhe anëtarësinë ekskluzive. Prandaj, kur Perikliu e përshkroi kushtetutën athinase si një «demokraci, sepse pushteti nuk është në duart e një pakice, por të gjithë popullit», dhe se «të gjithë janë të barabartë para ligjit», ai i referohej vetëm atyre të paktë që klasifikoheshin si qytetarë (Cammack, 2013). Perikliu dhe athinasit e tjerë kurrë nuk e konsideruan mundësinë që demokracia duhet të jetë një sistem i qeverisjes së, nga, dhe për *gjithë* popullin.

Ajo që jo rrallë-herë është harruar, është se fuqia e përcaktimit se cili është shtetas dhe cili jo është një akt i gjuhës politike *par excellence*. Qytetaria ishte dhe është një koncept i ndërtuar ku vijat e demarkacionit mbi ato që janë brenda apo jashtë janë një arenë e vazhdueshme beteje politike (Abowitz dhe Harnish 2006). Kështu pra demokracia e lashtë greke na 'dhuroi' formën

më të mirë te organizimit politik që ne njohim së bashku me tensionet dhe kontradiktat e saj. Duket sikur kemi mijëra vjeçarë që luftojmë të njëjtën betejë; përpjekje të vazhdueshme për t'u përfshirë dhe vendosmëri për të mos përfshirë. Artikulli argumenton që në këtë tension 'luhet' edhe sot beteja raciste dhe përpjekjet për zgjerim e të drejtave dhe përfshirjes.

DISKRIMINIMI DHE 'NDËRTIMI' I 'TJETRIT' RACOR

Sot është një fakt i pamohueshëm për gjenetistët dhe biologët që koncepti i "racës", në lidhje me qeniet njerëzore, nuk ka të bëjë me realitetin biologjik (Jacquard 1996). Nga njëra anë, koncepti i racës është përdorur si një mjet ideologjik i legjitimitimit për të shtypur dhe shfrytëzuar grupe të veçanta sociale, për t'i mohuar atyre akses në materiale, shërbimet e mirëqenies, strehimit dhe të drejtat politike në përgjithësi. Nga ana tjetër, edhe grupet e prekura kanë miratuar idenë e "racës". Ata e kanë kthyer konceptin për së prapthi dhe e kanë përdorur për të ndërtuar një alternativë pozitive vetë-identifikimi; ata e kanë përdorur atë edhe si një bazë për rezistencë politike (Miles 1993), dhe për të luftuar për më shumë autonomi politike, pavarësi, dhe pjesëmarrje.

'Racizmi' është një fjalë stigmatizuese dhe pjesë e betejës politike. Kjo fjalë është në buzët e pothuajse të gjithëve sot, dhe ndoshta për shkak se kuptimi i saj është zgjeruar jashtëzakonisht termi është bërë evaziv dhe i vështirë për t'u përkufizuar. Gjithmonë e më shumë dëgjojmë për racizëm 'gjenetik', 'etnopluralist', 'biologjik', dhe racizëm të përditshëm 'institucional', 'racizëm elite', 'i vjetër', 'i ri' ose 'neo-racizëm', 'racizëm pozitiv', si dhe 'racizmi i diferencuar', ndër të tjera. Për shkak të këtij përdorimi inflacionist, nuk ka një përkufizim gjërësisht të pranuar të termit. Prandaj artikulli do të konsiderojë vetëm disa nga qasjet e fundit terminologjike të konceptit.

Sipas Albert Memmi (2000: 103), «racizmi» i referohet vlerësimit të përgjithësuar dhe absolut të dallimeve reale apo fiktive që janë të dobishme për «akuzuesin» dhe në dëm të

viktimit të tij ose të saj. Me këtë gjykim negativ, paditësi kërkon të legjitimojë privilegjet apo agresionet e tij ose të saj." Kështu, Memmi sugjeron përdorimin e termit *heterofobi* vetëm për të treguar formën e gjykit diskriminues që përfshin vlerësimin e dallimeve reale apo fiktive biologjike. Sipas Memmi 'racizëm' në kuptimin e ngushtë duhet të kuptohet si një lidhshmëri të kundërshtash që bazohen mbi "heterofobinë" si për shembull 'arabo-fobi', 'zi-fobi', 'seksizmi', 'homofobi', 'të rinjtë-fobi' dhe 'fobi ndaj personave ndryshe'.

Përjashtë të tilla mundësojnë studimin e fenomenit. Por në situatën ku jetojmë, të komunikimit të menjëhershëm dhe politikanëve te super-instruktuar për të folur shumë e për të mos thënë asgjë, racizmi dhe diskriminimi, nga pikpamja dikursive, duhet parë jo domosdoshmërisht i lidhur me shprehjen e heterofobisë. Sot politikanët që pretendojnë të fitojnë zgjedhje, të pakten në publik, duket sikur janë heterofobiko-fobikë. Pra ato përpiqen të jenë gjithë-përfshirës në fjalime, në mbështetësit që paraqesin në media e kështu me rradhë. Prandaj menyra më e përshtatshme për momentin që jetojmë është të analizojmë elementët diskursive që ato përdorin në debate, në dukje pa lidhje me diskriminimin. Në këtë mënyrë mund të jemi në gjendje të dallojmë se çfarë mendojnë realisht dhe si është situata e racizmit në një polis të caktuar.

REFORMA USHATAKE NË SHQIPËRI – 'NUK JEMI TRIBU'

Artikulli analizon reformën ushtarake sepse është një nga ato reforma që kanë, në dukje, shumë pak lidhje me çështje diskriminimi apo gjithë-përfshirje. Faktikisht, në botë po diskutohet gjithmonë e më shumë mbi shërbimin në ushtri të personave gay apo transgender. Fakti që kjo çështje as që nuk është menduar për t'u diskutuar, është një tregues fillestar i faktit që edhe reforma e forcave të armatosura është bazuar mbi heterofobi ose të paktën mosvetëdijen e nevojës për më shumë përfshirje. Gjatë debateve në parlament u vu re përdorimi negativ i krahasimeve me femrat dhe njerëzit me

ngjyrë. Sidomos gjatë debatit mbi shkatërrimin e ushtrisë në vitin 1997 dhe 1998 vihet re përdorimi i krahasimeve me 'botën e trete' si një simbol i të keqes dhe përdorimit politik të ushtrisë. Jo rrallë herë parlamentarët akuzojnë kundërshtarët si diktatorë Afrikanë që vrasin njerëzit e tyre. Ndërsa një pjesë e ushtarakëve që dezertuan në 1997 akuzohen si burracakë me karakteristika femërore. Edhe gjatë luftës së Kosovës, gjatë debateve mbi kushtet e refugjatëve Kosovarë, parlamentarët akuzojnë komunitetin nderkombëtarë se ato po trajtohen si Afrikanë. Edhe më vonë, teksa Shqipëria avancoi në reformën ushtarake dhe integrimin në NATO gjuha e diskriminimit të nënkuptuar vazhdoi. Gjithashtu, edhe pse ushtria shqiptare vuan nga nën-përfaqesimi i grave, i Romëve dhe komuniteteve të tjera të marginalizuara ajo paraqitet në debatet parlamentare si një manifestim i suksesit të Shqipërisë pas rënies së komunizmit.

Pra pavarësisht se në diskursin e tyre politikanët shqiptarë përбетohen për besnikërinë ndaj gjithë-përfshirjes, ato në realitet janë ose të pandjeshëm ose kundërshtarë të heshtur të saj. Debatu mbi reformën në ushtri tregon se në elitën politike shqiptare diskriminimi nën rrogoz vazhdon të jetë i përhapur.

PËRFUNDIME

Ashtu si Grekët e vjetër, edhe shoqëritë moderne, dhe Shqipëria si pjesë e saj, përбетohen ndaj demokracisë dhe gjithë-përfshirjes. Gjithashtu, po si grekët e vjetër edhe ne e shikojmë demokracinë si një klub ekskluziv ku hyrja është e kufizuar dhe e vështirë. Ndryshe nga grekët e vjetër kemi përparuar shumë, por gjithashtu

kemi mësuar të kamuflojmë diskriminimin nën pektun e mbrojtjes së traditës apo thjesht duke gënjyer. Analiza e shkurtër e debatit mbi reformën ushtarake në Shqipëri tregon se po ata politikanë që në publik shqetësoheshin për barazinë, në parlament akuzonin njëritjetrin si gra apo ankoreshin se po trajtoheshin si Afrikanë. Prandaj diskursi politik duhet të ndryshojë që të dërgojë mesazhin se diskriminimi nuk pranohet. Për këtë nuk duhet një ndryshim tjetër kozmetik por një përjasje e re ideore. Prandaj rruga është ende e gjatë.

BIBLIOGRAFI

- Abowitz, K and Jason Harnish 2006, Contemporary Discourses of Citizenship, *Review of Educational Research*, Vol. 76, No. 4, pp. 653-690.
- Cammack, D 2013, *Rethinking Athenian Democracy*, Doctoral Dissertation, Harvard University.
- Coicaud, J 2002, *Legitimacy and Politics*, Cambridge University Press, Cambridge, UK.
- Jamieson, A 2015, Charleston church shooting: KKK, white supremacists operate in South Carolina, <http://www.msnbc.com/msnbc/charleston-church-shooting-kkk-white-supremacists-operate-south-carolina>
- Memmi, A 2000, *Racism*, University of Minnesota Press, St. Paul, MN.
- Minow, M 1990, *Making all the Difference*, Cornell University Press, New York, NY.
- Miles, R 1993, *Racism After Race-relations*, Routledge, New York, NY.
- Miller, F 2011, *Political naturalism*, <http://plato.stanford.edu/entries/aristotle-politics/supplement3.html>
- Smitherman, G and Teun van Dijk (Eds.) 1988, *Discourse and Discrimination*, Wayne State University Press, Detroit, Michigan.
- Perloff, R, 2014, *The Dynamics of Political Communication*, Taylor and Francis, New York, NY.
- Yack, B 1985, Community and Conflict in Aristotle's Political Philosophy, *The Review of Politics*, Vol. 47, issue 01, pp. 92-112.

Paraqitjet e një vendi të vogël dhe të largët në një media të madhe amerikane. Rasti i shqipërisë dhe vendeve ballkanike përballë mediave të mëdha perëndimore

Dr. BELINA BUDINI

Universiteti European i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit,
Përgjegjës i Departamentit të Komunikim, Marrëdhënie Publike



ABSTRAKT

Argumenti kryesor i studimit mëton se Shqipëria është ndërtuar dhe paraqitur në mënyrë konstante në revistën Time gjatë tre periudhave të studiuara (1923-1944; 1945-1989; 1990-2013). Mirëpo në këtë kumtesë do të analizohet vetëm pjesa e parë, ajo që lidhet me themelimin e shtetit të ri shqiptar. Pyetja themelore që shtrohet në këtë punim është: Si është ndërtuar dhe paraqitur subjekti i Shqipërisë ndërmjet viteve 1923-1944? Teza kryesore e ngritur si përgjigjie për pyetjen e mësipërme është: Subjekti i Shqipërisë përfaqësohet dhe trajtohet në mënyrë konstante nga ana e mediave të spektrit perëndimor si revista Time, në rrjedhën kohore 1923-1944.

Fjalë kyçe: Shqipëria në Time, Paraqitje të Shqipërisë në mediat perëndimore, Ligjërime i anormalitetit shqiptar, Mbulim mediatik i vendeve ballkanike

HYRJE: SHQIPËRIA NË TIME; ANALIZË E TË DHËNAVE SASIORE

Nuk është krejt e panjohur mënyra si mediat perëndimore e kanë paraqitur Shqipërinë.

Të paktën sa i takon periudhës post-komuniste, kur aksesimi në mediat e huaja u bë i mundur gjerësisht. Po kështu, në rrugë mediatike, kryesisht përmes televizionit, por edhe mediave të shkruara e tanimë edhe atyre online, kanë qarkulluar dhe vijojnë të qarkullojnë një pjesë e paraqitjeve që nuk i përkasin më të sotmes, por historisë. Artikuj, reportazhe, dokumentarë, filmime, fotografi, regjistrime dhe materiale nga më të larmishmet, të prodhuara nga mediat e huaja për Shqipërinë dhe shqiptarët kohë pas kohe, gjejnë hapësirë edhe në mediat vendase. Mirëpo, megjithë këtë njohje të përgjithshme dhe interes të treguar ndaj mënyrës si të tjerët, sidomos mediat perëndimore e shohin Shqipërinë, studime sistematike në lidhje me zhvillimin e këtyre paraqitjeve dhe mënyrën si është parë Shqipëria historikisht, nuk janë bërë. E konsideruar si revista më me ndikim në botë dhe me audiencën më të lartë për një të përjavshme të aktualitetit, Time është një media e referuar veçanërisht nga historianët. Të shkruajë historinë çdo javë, ky është pretendimi i shpallur i vetë revistës. Ndërsa pretendimi i këtij punimi është të studiojë paraqitjet sasiore të Shqipërisë nga Time vetëm për periudhën 1923-1944.

HIPOTEZA DHE ARGUMENTET KRYESORE

Argumenti kryesor i studimit mëton se Shqipëria është ndërtuar dhe paraqitur në mënyrë konstante në revistën Time gjatë tre periudhave të studiuara (1923-1944; 1945-1989; 1990-2013). Mirëpo në këtë kumtesë do të analizohet vetëm pjesa e parë, ajo që lidhet me themelimin e shtetit të ri shqiptar.

Pyetja themelore që shtrohet në këtë punim është: Si është ndërtuar dhe paraqitur subjekti i Shqipërisë ndërmjet viteve 1923-1944?

Teza kryesore e ngritur si përgjigjie për pyetjen e mësipërme është:

Subjekti i Shqipërisë përqaset dhe trajtohet në mënyrë konstante nga ana e mediave të spektrit perëndimor si revista Time, në rrjedhën kohore 1923-1944.

METODOLOGJIA E PUNIMIT: PËRQASJE EMPIRIKE TEORIKE

Ky punim mbështetet në një qasje metodologjike të kombinuar brenda traditës empirike të kërkimeve dhe studimeve në media. Kombinimi konsiston në dy drejtime metodologjike siç janë:

Së pari, studimi tekstual për sa i përket përmbajtjes së artikujve në terma sasiorë dhe cilësorë.

Së dyti, studimi fenomenologjik në kuadër të agjencisë mediatike në vetvete dhe në raport me Shqipërinë.

Drejtimi i parë, si pjesë e traditës së kërkimeve empirike në media, njihet me emrin analizë teksti. Kjo kumtesë përqendrohet pikërisht në këtë drejtim kryesor. Për sa u përket përmbajtjeve të artikujve, kërkimet e hollësishme janë orientuar drejt leximit nga afër të lajmeve si narrativa, të mbushura me kode dhe simbole, për interpretimin e të cilave shërben, në radhë të parë, vetë teksti, si dëshmi e procesit të prodhimit të tij. Analiza e tekstit është realizuar përmes teknikave të kodifikimit, tipologjizimit dhe interpretimit të formateve dhe përmbajtjes së Time, regjistrimit numerik, identifikimit të fjalëve, fjalive dhe konstrukteve kyçe, mënyrave dhe formave të të shprehurit, me

pak elementë gjuhësorë që lidhen më tepër me analizën e stilit dhe të strukturës së të shkruarit gazetaresk. Kjo perspektivë interesohet, gjithashtu, më tepër sesa të tjerat, për origjinën dhe evoluimin e përmbajtjeve mediatike, ndaj i përgjigjet hipotezës sonë në mënyrë më të përshtatshme dhe të plotë, kryesisht në terma cilësorë, por edhe në terma sasiorë.

SHTETI I RI SHQIPTAR, NJOHJA NGA TIME

Analizë e të dhënave sasiorë

Është e vakët dijenia mbi raportimet e shtypit perëndimor në lidhje me Shqipërinë në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, gjatë regjimit të Ahmet Zogut dhe gjatë Luftës së dytë Botërore. Aq më pak është studjuar nga afër dhe në mënyrë sistematike kjo kohë e Shqipërisë, në këndvështrimin e mediave perëndimore. Mirëpo kjo përbën një ndër periudhat kur raportimet nuk kanë munguar dhe kur në mediat e huaja si revista Time reflektohej njohje e shtetit të ri shqiptar si edhe drejtuesve të tij.

Të dhënat e gjeneruara nga kërkimi në bazën dixhitale të të dhënave të revistës Time nxjerrin 253 rezultate për "Shqipërinë" nën fjalë-kërkimin Shqipëria (Albania) për periudhën ndërmjet Prillit të vitit 1923 dhe Korrikut të vitit 1944. Të renditura sipas rëndësisë (relevance) të dhënat megjithatë i janë nënshtruar filtrimit të mëtejshëm, me qëllim që të bëheshin domethënëse dhe të vlefshme për analizë dhe interpretim. Kjo është arsyeja përse është përdorur një kriter tjetër klasifikimi për matjen e rezultateve të kërkimit rreth Shqipërisë, duke konsideruar vetëm ato raste kur Shqipëria është përmendur në titullin ose në paragrafin e parë të artikullit. Pra janë lënë jashtë interpretimit dhe analizës së hollësishme artikujt ku Shqipëria përmendet në një kontekst më të përgjithshëm ose periferik, por nuk del që në titull apo në paragrafin e parë.

Rezultatet e kërkimit, sipas këtij kriteri, shfaqin 63 artikuj, ndër të cilët 42 e kanë Shqipërinë të përmendur në titull dhe 21 në paragrafin e parë. Nga këta artikuj, 31 kanë në titull ose në paragrafin e parë emrin e Ahmet Bej Zogut, të cilit ose i kushtohen tërësisht, ose

i referohen gjerësisht. Pjesa më e madhe e artikujve janë vendosur në rubrikën "Foreign News" sipas emërimit të kohës ose "World" siç është riorganizuar në arkivën online të Time. Sipas rëndësisë, artikujt për Shqipërinë janë të vendosur edhe në rubrika të tjera si Nation, War & Terrorism, Milestones, Letters, Religion, etj. Po kështu, në raport me mbulimin që marrin nga Time vende të tjera të rajonit ose më gjerë, të dhënat përforcojnë pohimin e mësipërm të një pranie relativisht të lartë të Shqipërisë në faqet e kësaj reviste. Kështu, pas një krahasimi të të dhënave, të cilat mund t'i gjeni edhe në tabelën "Vendet e rajonit sipas mbulimit nga Time", ndërsa Shqipëria del e përmendur në 253 artikuj në total, Serbia del në 123 syresh, Mali i Zi në 65 artikuj, Maqedonia në 47, Kroacia në 68, edhe pse ka edhe një kontekst të përbashkët kur këto vende dalin nën emërtimin Jugosllavia që rezulton në 533 artikuj. Duhet theksuar se shifrat e mësipërme nuk flasin për daljen e këtyre vendeve në titujt ose në paragrafët e parë të artikujve, por në përmbajtjen më të gjerë të këtyre artikujve, duke qenë se për këto të dhëna është përdorur kërkimi dixhital i arkivës së revistës. Vendet që marrin më shumë mbulim se Shqipëria në rajon janë Greqia që del e përmendur në 975 artikuj, Rumania në 1021 artikuj dhe Bullgaria në 464 artikuj. Edhe të dhënat e raportimeve për Shqipërinë vit pas viti tregojnë që Time e ka parë dhe trajtuar Shqipërinë e viteve '20-'40 si entitet domethënës dhe me vlerë lajmi. Në aspektin kohor, ky interesim ka kulmuar në vitin 1927, gjë që lidhet me kursin e ri në marrëdhëniet e Shqipërisë me jashtë dhe nënshkrimin e Traktatit të Tiranës me Italinë. Interesim i lartë është treguar edhe gjatë vitit 1924, kur Shqipërisë i kushtohen 7 artikuj, gjë që lidhet vetëm me zhvillimet e brendshme dhe politike në vend. Deri në vitin 1929 interesimi mbetet i lartë me 7 artikuj të botuar, ndërsa vitet e stabilitetit politik në vend marrin më pak mbulim, edhe pse artikujt nuk mungojnë. Që nga viti 1938, numri i artikujve në vit për Shqipërinë është sërish në rritje dhe vitet 1939, 1940, 1941 shfaqin 16 artikuj, gjë që lidhet me zhvillimet e Luftës së Dytë Botërore. Vitet '43-'44 marrin më pak artikuj dhe zhvillimet e

brendshme janë jashtë fokusit të saj, pasi revista është e përqendruar tek Shqipëria vetëm si front beteje. Konteksti i brendshëm i zhvillimeve në vend, gjatë periudhës së luftës civile, nuk merr të njëjtën vëmendje, po të kemi parasysh që në kohë të qeta në arenën ndërkombëtare, Shqipërisë nuk i ka munguar interesimi nga revista dhe interpretimi i ngjarjeve të brendshme.

Më shumë rreth logjikës së mbulimeve të Shqipërisë nga Time do të zbulojë edhe analiza përmbajtësore e artikujve. Siç sugjerohet më tej, nga këto përmbajtje del se revista ka operuar kryesisht sipas një logjike të brendshme dhe një linje të sajën për përzgjedhjen dhe ndërtimin e historive rreth Shqipërisë, edhe pse është influencuar nga pasqyrime të tjera gazetareske të kohës. Kështu, revista ka ndërtuar një rrëfenjë të sajën për Shqipërinë, e cila krijon vazhdimësi dhe lidhje në kohë që nga vitet '20 të shekullit të kaluar dhe përgjatë viteve '30 dhe '40, por edhe më tej në periudhat e tjera kohore, vitet e regjimit komunist dhe ato të tranzicionit drejt demokracisë. Se çfarë Shqipërie ka krijuar dhe ndërtuar, kjo do të bëhet më e qartë në seksionin e analizës së ligjëritimit

NGJARJET DHE TEMAT: POLITIKË DHE GOSSIP MBRETËROR

Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se Shqipëria ka marrë më tepër mbulim në kuadër të zhvillimeve të saj të brendshme sesa në kuadër të zhvillimeve ndërkombëtare. Shqipëria del në 25 artikuj në kuadër raportimesh për ngjarje ndërkombëtare dhe në 38 artikuj në kuadër raportimesh për zhvillime të brendshme të Shqipërisë. Të dhënat më të detajuara tregojnë se është Lufta e Dytë Botërore ajo që zë pjesën më të madhe të raportimeve për Shqipërinë, në kuadër të zhvillimeve të tjera ndërkombëtare me 16 artikuj, ndërsa më pak zënë zhvillimet ndërkombëtare në Lidhjen e Kombeve dhe të gjeopolitikës e të diplomacisë me nga 3 artikuj.

Ndërkaq, në kuadër të zhvillimeve që burojnë së brendshmi në Shqipëri, numri më i madh i tyre, 18 artikuj, i përkasin politikës së brendshme shqiptare, që nënkupton raportime

rreth reformave qeveritare dhe shtetërore në Shqipëri, por edhe zhvillime e konflikte politike ndërmjet qeverisë dhe opozitës në vend, si edhe raportime rreth marrëdhënieve me vendet fqinje apo me SHBA, që dalin në kuadër të politikës së jashtme të Shqipërisë gjatë kësaj periudhe. Kështu 7 artikuj për zhvillimet e brendshme shqiptare trajtojnë marrëdhëniet e Shqipërinë më Italinë dhe 2 prej tyre ato me SHBA-të, ndërsa vetëm një artikull trajton çështjen e religjionit në vendit tonë.

Nga ana tjetër, gjithnjë në kuadër të zhvillimeve të brendshme në vend, është shumë më i lartë numri i artikujve që u kushtohen kronikës rozë dhe jetës personale të mbretit Zog dhe familjes mbretërore. Ka 10 artikuj në këtë revistë që raportojnë rreth martesës dhe historive të dashurisë së mbretit Zog. Në këtë kronikë ka edhe raportime për personat më afër tij, si mbretëresha Geradinë, motrat e Zogut dhe ndonjë lidhje të tij intime, deri tek trashëgimtari i tij i porsalindur, që gjithashtu do të bëhet pjesë e kronikave rozë dhe atyre politike në vitet në vazhdim, gjatë periudhave 1945-1990 dhe 1990-2013.

PARAQITJET E NJË SHQIPËRIE ANORMALE; ANALIZË LIGJËRIMI

Pas dokumentimit numerik të mbulimeve që revista Time i ka bërë Shqipërisë së periudhës ndërmjet viteve 1923-1944, në këtë pjesë të punimit do të shihet edhe më nga afër gjuha e përdorur, narrativat dhe mënyra e ndërtimit të artikujve.

Shqipëria merr përshkrime me ngjyra mjaft të forta parodizuese, një gjuhë me figuracion të lartë shprehës (gjuhë metaforike) dhe që me ngjyrimet e saj krijon kontraste të forta herë simpatizuese, herë stigmatizuese për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ndërsa, siç përcaktohet më poshtë, ligjërimi mbizotërues është ai i anormalitetit.

Një prej leximeve që lidh shumicën e artikujve për Shqipërinë, është diskursi ose ligjërimi i anormalitetit. Ky ligjërim paraqitet mbizotërues si pamje dhe lexim përgjithësues për këto artikuj, mbështetur në analizën sasiore dhe

cilësore (pra, nga të dhënat sasiore, se sa shpesh del një ligjërim i caktuar në artikuj dhe nga analiza e përmbajtjes, se si është shprehur ai në këto artikuj).

Ligjërimi i anormalitetit mbështetet në një varg konstruksionesh dikotomike që propozon revista artikull pas artikulli. Kështu, përmes mjeteve të fuqishme shprehëse si parodia dhe gjuha e figurshme metaforike, Time ndërton një pamje të Shqipërisë plot kontraste dhe ngjyrimet ekstreme.

Revista vizaton një Shqipëri të “ekstremeve” (gjë që përbën një konstante në paraqitjet për Shqipërinë në të tre ndarjet kohore), me relief dhe mot ekstrem, me varfëri ekstreme, me zhvillime politike ekstreme, me drejtues dhe figura drejtuese ekstremiste, me tradita dhe zakone ekstreme. Megjithëse këto konstruksione janë mjaft të pasura me figuracion stilistikor, është e qartë se këtu nuk kemi të bëjmë thjeshtë me përdorim të një gjuhe “ekstremizuese” si teprim stilistikor. Kjo është një mënyrë specifike ndërtimi dhe paraqitjeje e Shqipërisë si pjesë e ligjëritimit të anormalitetit, qoftë ai vetëm shqiptar ose më gjerë ballkanik, ligjërim i cili gjen përdorim të gjerë në mediat amerikane dhe ato perëndimore në përgjithësi në lidhje me Shqipërinë.

Në një artikull të datës 11 janar 1937, Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë cilësohet si “*vrima më e keqe në Europë*” (“the worst hole in Europe”). Ky pohim del në kontekstin e vështirësisë që ka mbreti Zog për të gjetur një kandidate të denjë për mbretëreshë në Shqipëri, ku “Tirana, kryeqyteti malor i mbretërisë së vogël, konsiderohet nga diplomatët si vrima më e keqe në Europë”¹. Formulimi në shkallën sipërore “më e keqe në Europë” flet këtu për një konstruksion gjuhësor “ekstremizues”, që i brendashkruhet ligjëritimit të përgjithshëm të anormalitetit si “vend i keq” që përbën edhe në këtë rast një vlerësim ekstremizues, pasi nënkupton “i keq në gjithçka”, pa sugjeruar asnjë element specifik në lidhje me karakteristikat që e bëjnë të keq. Në një artikull të vitit 1927, për Tiranën flitet gjithashtu me termat ekstremizues dhe stigmatizues njëherësh kur përshkruhet si “ai

¹ Revista Time, “Albania: Fatima—or Else!”, 11 janar 1937

*kryeqytet i vogël, i shëmtuar, i neveritshëm*². Duke iu referuar sërish Tiranës, Time e vizaton atë si “një kryeqytet tipik ballkanik, i trazuar dhe me erë të keqe” duke e vendosur kësaj radhe në konstruktin më të gjerë të “anormalitetit ballkanik” për sa i përket rendit publik dhe higjenës apo kulturës së jetesës, edhe pse në këtë rast epiteti “i keq” është përdorur në mënyrë më specifike duke përshkruar erën e pakëndshme dhe ndotjen e ajrit të qytetit³. Sipërorja krahasuese del edhe në formulime të tjera më realiste në dukje si “*kombi më i vogël në Ballkan*”, por që në këtë rast shërben për ta theksuar edhe më tepër përkajimin zvogëlues, duke e vendosur brenda njësisë gjeografike edhe vetë “*të vogël*” dhe “*të trazuar*”, rajonit të Ballkanit⁴. Në të vërtetë, ky lloj formulimi i shkallës sipërore, në këtë rast zvogëluese, jo zmadhuuese, është ndër konstruksionet më të shpeshta gjuhësore që shfaqet sa herë del edhe emri i Shqipërisë, si të ishte një kartvizitë e saj, në formën “mbretëria e vockël e Shqipërisë” apo “mbretëria shumë e vogël ballkanike e Shqipërisë”⁵. Përshkrime të tilla evidentojnë një Shqipëri “ekstreme” për nga përmasat e saj. Njëlloj si për Shqipërinë, flitet në terma “zvogëluese” dhe “ekstremizuese” edhe për vetë figurën e saj kryesore politike në këtë periudhë, Ahmet Zogun, i cili referohet herë si “*mbreti i vogël Zog*”, herë si “*një diktator vetëm 31 vjeç*” dhe herë të tjera si “*shëf i fiseve më të fuqishme feudale shqiptare*” apo si “*një nga njerëzit më të varfër të Europës*” në disa artikuj që nga viti 1927 deri në vitin 1940⁷.

Mirëpo, të zakonshme janë edhe konstruktet gjuhësore që flasin për karakteristika të tjera gjeografike ekstreme siç është relievi ekstrem i vendit, si për shembull “*malet e egra prapa Tiranës*” apo “*përmes maleve të thepisura të Shqipërisë*”, ose “*majat e maleve të Shqipërisë së vogël të thepisur*” apo “*kryeqyteti në majë të*

maleve të mbretërisë së vockël të Shqipërisë”, ku del se Tirana është një kryeqytet në majë të maleve të thepisura apo se është e rrethuar nga male të egra, ndërsa Shqipëria është një vend i thepisur si greminë⁸. Karakteristikat e një moti ekstrem, në kontrast me përshkrimet e mësipërme të relievit gjeografik, përbën një tjetër element të ligjërit të anormalitetit shqiptar. Kështu në një artikull ku flitet për ceremoninë e kurorëzimit mbret të Ahmet Zogut, Time përshkruan atmosferën e brohoritjeve për Mbretin e shqiptarëve në “*rrugët e ngushta të Tiranës, kryeqytetit të pistë të Shqipërisë, që si zakonisht djeriste nën një diell përvëlues*”⁹. Ndërsa në kronikat gjatë luftës së dytë botërore përshkrimet flasin më tepër për një Shqipëri të acartë nën dëborë: “*Javën e shkuar dëbora shtresëzohej në majat dhe lugjet e Shqipërisë së vogël të thepisur si greminë*”¹⁰. Ligjërimi me ngjyra ekstreme në kuadër të ligjërit të përgjithshëm të anormalitetit në artikujt e Time për Shqipërinë shfaqet edhe në mënyrën si paraqiten njerëzit dhe jeta sociale në vend. Si për shembull një artikull i vitit 1928, i përshkruan kështu shqiptarët: “*të ndotur, mjeranë, të varfëruar, të pickuar nga mushkonjat, të ngordhur urie, të troshitur nga tërmeti*”¹¹. Në të njëjtin artikull dallohen edhe paraqitjet kontrastuese të brendshme, pra ndërmjet vetë shqiptarëve, pasi në thelb të artikullit qëndron ndërtimi i kontrastit ndërmjet shqiptarëve të thjeshtë dhe drejtuesit të tyre, që zgjedh të shndërrohet nga president në mbret në një vend ku, sipas artikullit, ai mund t’i plotësojë qefin vetes të quhet, po të dojë, edhe “pasha” apo “car”, sepse në jetët e njerëzve kjo ngjarje nuk bën dallim. Edhe kur bëhet fjalë për zhvillimet politike në vend, ligjërimi mbizotërues është ai i anormalitetit. Madje, pikërisht anormalja përbën normën dhe të natyrshmen në zhvillimet dhe jetën e një vendi si Shqipëria, sipas pohimit

² Revista Time, “Albania: Agent Provocateur”, 21 mars 1927

³ Revista Time, “Zog’s Choice”, 7 shkurt 1938.

⁴ Revista Time, “Albania: A noose for Benito”, 7 qershor 1943

⁵ Revista Time, “Albania: Birth and Death”, 17 prill 1939

⁶ Revista Time, “International: Madmen and Fools”, 17 prill 1939

⁷ Revista Time, “Albania: Supreme Removal”, 21 mars 1932; Revista Time “Albania: Piratical Dictature”, 11 prill 1927; Revista Time “Albania, President into King”, 27 gusht 1928; Revista Time “Albania: Zog’s Furs”, 6 maj 1940

⁸ Përkatesisht në artikujt e Time: “Albania: A noose for Benito”, 7 qershor 1943; “Zog’s Choice”, 7 shkurt 1938; “Balkan Theater: Children of Socrates”, 9 maj 1938; “Albania: Birth and Death”, 17 prill 1939

⁹ Revista Time, “Albania: Koran and Bible”, 19 shtator 1928.

¹⁰ Revista Time, “Balkan Theater: Children of Socrates”, 9 dhjetor 1940

¹¹ Revista Time, “Albania, President into King”, 27 gusht 1928

të drejtpërdrejtë që bën një artikull i revistës i vitit 1924, që trajton situatën politike në vend: "Nuk ka gjë më të natyrshme, sidomos në një vend të prapambetur, sesa dëshira e një kryeministri të rrëzuar që të kthehet dhe të rrëzojë pasuesin që e kishte rrëzuar"¹². Në lidhje me rendin dhe qetësinë, po kështu *Time* vendos kriterin e lajmit, duke u shprehur se "një vrasje në mugëtitirë nuk përbën aspak lajm në Tiranë, atë kryeqytetin e shëmtuar, të neveritshëm"¹³.

Mirëpo, ligjërimi i anormalitetit që dominon si temë kryesore e përmbajtjeve të artikujve, edhe pse është qartazi stigmatizues, duhet lexuar ose interpretuar brenda kontekstit të ligjërimin parodizues, që karakterizon revistën në tërësi për këtë periudhë. Stili parodizues deri në kufijtë e vetë-parodizimit është karakteristika kryesore e ligjërimin të *Time* në këto vite, pavarësisht se cili është subjekti i artikujve të saj, një shtet i vogël (si Shqipëria e cila merr sidoqoftë mbulim të shpeshtë), presidenti i SHBA-ve (Franklin Rusvelt, të cilit revista nuk i kursen as përshkrimin e këmbëve të tij të sëmura, duke shkaktuar një skandal në SHBA) apo qoftë edhe ngjarje solemne, siç është një ceremoni mortore (kur përshkruan varrimin e Leninit në Moskë, duke parodizuar kortezhet nën motin e acartë, që i bënte zogjtë të binin të vdekur në dëborë). Një revistë si *Time* që nuk kursente asgjë dhe askënd, Shqipërinë "e vogël" e ka parodizuar gjithashtu fare lirisht.

REFERENCAT

- Abrahamson David. *Magazine-Made America: The Cultural Transformation of the Postwar Periodical*. Cresskill, NJ: Hampton Press: 1996.
- Angeletti Norberto, Olivia Alberto, TIME, *The Illustrated History of the World's Most Influential Magazine*: Rizzoli, 2010.
- Berger Peter L. Luckmann Thomas, *The Social Construction of Reality: A Treatise in the Sociology of Knowledge*, Open Road Media, 2011.
- Dell'Orto, Giovanna, *Giving Meaning to the World: The First US Foreign Correspondents, 1838-1859*, Greenwood Press: Westport, 2002. Fq 121.

Dominick Joseph R., *Dinamikat e komunikimit masiv*, UET Press: 2010. Fq 210-211.

D'Angelo Paul, Jim A. Kuypers (eds), *Doing News Framing Analysis: Empirical and Theoretical Perspectives*, Routledge, 2009.

Elson Robert T., *Time Inc. The intimate history of a publishing Enterprise, 1923-1941*, Scribner: 1985.

ARTIKUJ SHTYPI

- Revista *Time*, "Albania: Fatima—or Else!", 11 janar 1937
- Revista *Time*, "Zog's Choice", 7 shkurt 1938.
- Revista *Time*, "Albania: Agent Provocateur", 21 mars 1927
- Revista *Time*, "Albania: A noose for Benito", 7 qershor 1943
- Revista *Time*, "Albania: Birth and Death", 17 prill 1939
- Revista *Time*, "International: Madmen and Fools", 17 prill 1939
- Revista *Time*, "Albania: Supreme Removal", 21 mars 1932;
- Revista *Time* "Albania: Piratical Dictature", 11 prill 1927;
- Revista *Time* "Albania, President into King", 27 gusht 1928;
- Revista *Time* "Albania: Zog's Furs", 6 maj 1940)
- Revista *Time*: Zog's Choice", 7 shkurt 1938;
- "Balkan Theater: Children of Socrates", 9 maj 1938;
- Revista *Time*, "Albania: Koran and Bible, 19 shtator 1928.
- Revista *Time*, "Balkan Theatre: Children of Socrates, 9 dhjetor 1940
- Revista *Time*, Albania: Zog's Furs, 6 maj 1940
- Revista *Time*, "Albania: Joust, 22 dhjetor 1924
- Revista *Time*, "Albania: Fatima—or Else!", 11 janar 1937
- Revista *Time* "Milestones", 27 janar 1936
- Revista *Time* "Albania: Jugoslavs v. Greeks", 15 nëntor 1926
- Revista *Time*, "Italy: Lost and Found", 3 tetor 1938;
- Revista *Time*, Albania: Swiss Laws, Geek Patriarch", 15 prill 1929
- Revista *Time*, Albania: Wilson, 25 gusht 1924;
- Albania: Port Wilson, 19 shtator 1929
- Revista *Time*, "The League of Nations: Albania Accuses", 20 qershor 1927
- Revista *Time*, "The League of Nations: Business" 29 dhjetor 1924
- Revista *Time*, "A constitution coming", 11 shkurt 1924
- Revista *Time*, Albania: Momentous Buttons", 19 nëntor 1928
- Revista *Time*, Albania: Albania, 14 prill 1923
- Revista *Time*, Albania: Zog not Skanderbeg, 17 qershor 1929
- Revista *Time*, "Albania, Footlose Zog", 19 qershor 1933
- Revista *Time*, "Albania: International Cough", 8 korrik 1929
- Revista *Time*, "Albania: Zog and Jerry", 9 maj 1938
- Revista *Time*, "Albania: King Job", 7 prill 1924
- Revista *Time*, "International: Scared", 28 mars 1927
- Revista *Time*, International: Madmaen and Fools", 17 prill 1939;
- Revista *Time*, "The Cabinet; Inscrutable Design", publikuar në 17 prill 1939
- Revista *Time*, "Milestones", 27 janar 1936
- Revista *Time*, "Albania: Blatant Accusations" 17 janar 1927
- Revista *Time*, Milestones, 17 prill 1939

¹² Revista *Time*, "Albania: Joust, 22 dhjetor 1924

¹³ Revista *Time*, "Albania: Agent provocateur, 21 mars 1927

Mediat dhe “grupet e pazëshme” në Shqipëri

GILMAN BAKALLI, PhD

Lektor, Departamenti i Komunikim, Marrëdhënieve Publike, Universiteti European i Tiranës



Abstrakt

Ky studim synon të aplikojë në realitetin shqiptar teorinë e grupeve të pazëshme të propozuar që në vitin 1974 nga Chervis Kramarae, sipas së cilës gjuha si një sistem shenjash është krijuar nga burrat dhe si e tillë ajo nuk u shërben njëloj të dyja gjinive, por i diskriminon gratë, duke mos i lejuar ato të shprehen në publik pa qenë të detyruara të huazojnë nga leksiku mashkullor. Hulumtimi do të fokusohet tek një analizë tekstuale të teksteve të prodhuara nga gra të suksesshme nga fusha e politikës dhe biznesit. Kjo analizë teksti pret të vërtetohet hipoteza e Kramarae se gratë, në fjalime publike, huazojnë një ligjërim të bazuar në analogji sportive dhe luftarake dhe konkurrionale.

Fjalë kyçe: Gjuha, Kultura, Media, Shqipëri, Femra, Stili

HYRJE

Të shumta janë studimet mbi komunikimin dhe përkatësinë gjinore. Të gjitha fokusohen tek mënyra se si gjinia ndikon gjuhën dhe dinamikën e saj në realitetin social. Ne do të

fokusohemi tek njëra nga këto studiuese, Chervis Kramarae, profesoreshë e komunikimit dhe sociologjisë në universitetin Illinois. Kramarae beson se një karakteristikë kryesore e realitetit është natyra e tij lingvistike dhe se fjalët dhe sintaksa e mesazheve strukturojnë mënyrën e të menduarit dhe të ndërvepruarit. Implikimet gjinore të gjuhës janë fokusi kryesor i Kramarae, e cila mendon se mesazhet njerëzore i trajtojnë femrat dhe meshkujt në mënyra të ndryshme. Asnjë eksperiencë njerëzore nuk i shpëton influencës lingvistike. Edhe kategoritë *mashkull* e *femër* janë konstrukte lingvistike. Me fjalë të tjera “jemi trajnuar të shohim dy sekse. Dhe më pas vazhdojmë të përpiqemi të shohim vetëm dy sekse”. Kramarae jo vetëm që evidenton rëndësinë e gjuhës në interpretimin e eksperiencave, por edhe adreson dimensionin e pushtetit. Çdo sistem gjuhësor përmban elemente pushteti dhe ato që janë pjesë e sistemit lingvistik dominant ka gjasa t’i kenë perceptimet, përjetimet dhe mënyrat e të shprehurit të inkorporuar në gjuhë. Në këtë rast, Kramarae mendon se gjuha angleze është një gjuhë meshkujsh (“man-made language”) dhe si e tillë ajo mishëron perspektivën mashkullore më tepër se atë femërore. Kramarae beson se gjuha është një

konstrukt i krijuar nga burri dhe, si e tillë, i shërben krijesit të saj:

“Gjuha e një kulture specifike nuk i shërben njëlloj në mënyrë të barabartë, gjithë folësve të saj, sepse jo të gjithë folësit e saj kontribuojnë njëlloj në formulimin e saj. Gratë (dhe anëtarë të tjerë të nëngrupeve të varura sociale) nuk janë aq të lira dhe aq të afta sa burrat të thonë atë që dëshirojnë të thonë, kur dhe ku ato dëshirojnë ta thonë, sepse fjalët dhe normat për përdorimin e tyre janë formuluar nga grupi dominant, burrat”. (Kramarae, 58)

Sipas Kramarae, fjalët e grave merren me rezerva në shoqërinë tonë, mendimet e tyre zhvlerësohen dhe kur ato mundohen ta kapërcejnë këtë pabarazi, kontrolli mashkullor i komunikimit i vendos ato në një dizavantazh të dukshëm. Gratë kthehen kështu në një grup të pazëshëm (muted group). (studimi Kramarae bazohet në analizën e 60 filmave vizatimorë, mënyra se si portretizohen gratë në këto filma). Ideja e grave si një grup i pazëshëm është propozuar fillimisht nga antropologët e Oksfordit Edwn Ardener dhe Shirley Ardener. Në monografinë e tyre “Besimi dhe problemi i grave”, ai nënvizon tendencën e çuditshme të shumë etnografëve që pretendojnë se e kanë gjetur “kodin” e një kulture pa bërë as edhe një referencë direkte ndaj gjysmës së shoqërisë të përbërë nga gratë. (Griffin, 461). Etnografët justifikohen duke përmendur vështirësitë në lidhje me studimet në terren, sidomos vështirësitë për të përdorur gratë si informatore të një kulture të caktuar. Ardener e pranon këtë vështirësi, por u kujton kolegëve se sa e dyshimtë është puna e një antropologu, i cili shkruan mbi burrat e një fisi duke u bazuar vetëm në thëniet e grave. Fillimisht Ardener mendonte se kjo mungesë vëmendjeje ndaj eksperiencës së gruas ishte tipike për antropologjinë, por më pas ai konstatoi se ky jo artikulum buronte nga mungesa e pushtetit të një grupi, i cili ka një pozicion të poshtëm në hierarkinë sociale. Njerëzit me pak pushtet kanë vështirësi me artikulin e perceptimeve të tyre. Sipas Ardener, “grupet e detyruara për të mos u artikuluar janë prezentë, por nuk mund të shquhen në gjuhën e strukturës dominante; si rezultat ato anashkalohen, bëhen të padukshme: thjesht vrima të zeza në universin e dikujt tjetër”. (Griffin, 470)

Natyrisht që grupet e pazëshme nuk janë të heshtura gjithmonë. Çështja është nëse njerëzit mund ta thonë atë çka duan ta thonë kur dhe aty ku duan ta thonë, apo “janë të detyruar t’i rakordojnë mendimet e tyre për t’u bërë më të kuptueshme në domenin publik”?

Kramarae është e bindur se pozicioni i pushtetshëm i burrit në shoqëri garanton që mënyra publike e të shprehurit nuk është në favor të gruas. Ajo arsyeton se dallimi i përhershëm gjuhësor *publik-privat* është një mënyrë e përshtatshme për të ekzagjeruar diferencat gjinore dhe për të fiksuar sfera të ndara seksuale të aktivitetit. Brenda logjikës së kësaj dysheje, fjalët e grave zakonisht konsiderohen të përshtatshme brenda shtëpisë – si realitet i vockël i komunikimit ndërpersonal. Ky realitet privat në një farë mënyre konsiderohet si më pak i rëndësishëm se “bota e madhe” e debatit publik – një vend ku gjejnë pasqyrim fjalët e burrave. Kramarae pyet, “çfarë do ndodhte sikur të kishim një fjalë që do të lidhte komunikimin publik me atë privat”? nëse do ekzistonte një fjalë e tillë në fjalorin e secilit, përdorimi i saj do të krijonte idenë se të dyja sferat kanë të njëjtën vlerë dhe se ngjashmëritë midis burrit dhe gruas janë më të rëndësishme se dallimet mes tyre.

Pra, Kramarae përpiqet t’i heqë maskën një sistemi linguistik që synon mbytjen e zërit të gruas, duke krijuar terma specifik-gjinor përçmues për gruan, p.sh për llafazanërinë e pretenduar si tipike të saj. Ajo konstaton se ka dhjetëra e dhjetëra specifikime gjuhësore për ta paraqitur gruan si llafazane dhe shumë pak për ta zhvlerësuar llafazanërinë e burrave. Po ashtu edhe termat gjuhësorë për të përshkruar shthurjen seksuale të individit japin një panoramë të tillë: rreth 22 fjalë për të etiketuar sjelljen e shthurur të burrave (zhigolo, don zhuan, playboy etj) dhe mbi 22 etiketime për gratë e së njëjtës kategori. Duke qenë se shumica e studimeve mbi aktivitetin seksual tregojnë se janë burrat e jo gratë që ndërrojnë më shpesh partnerët seksualë, raporti i pabarabartë i termave gjuhësorë për të përshkruar sjelljen e gruas tregon i shërben interesit të burrave.

Sipas hipotezës së Sapir-Whorf, gjuha formon perceptimin tonë të realitetit. Duke u bazuar mbi këtë tezë, Kramarae sugjeron se gratë shpesh heshtin duke mos pasur një fjalor të njohur e të pranuar publikisht, nëpërmjet të cilit të përshkruanin eksperiencat e tyre. Ajo shprehet se “fjalë të injoruara vazhdimisht eventualisht mund jo vetëm të mos artikuloohen më, por edhe të mos mendohen më. Pas një farë kohe, gratë e detyruara të mos artikulojnë, mund të vënë në dyshim vlefshmërinë e eksperiencave të tyre dhe bile edhe legjitimitetin e ndjenjave të tyre” (Kramarae, 78).

Duke qenë se gratë janë verbalisht të pazëshme, ato reagojnë në forma të ndryshme. Ato mbështeten tek shprehjet jo verbale më tepër sesa burrat. Përveç kësaj gratë priren të shfaqin një larmi ekspresive që manifestohet në forma specifike gjuhësore jashtë sistemit dominant të burrave. Krijimi i formave alternative ekspresive është karakteristikë e të gjitha grupeve sociale të pazëshme. (shembull i praktikës gjatë kohës Underground Railroad me varjen në tel të jorganëve me modele të ndryshme për të orientuar skllëvërit që kërkonin të arratiseshin). Një shembull bashkëkohor i kësaj që po themi është libri “Women Speak: The Eloquence of Women’s Lives” të Karen Foss dhe Sonja Foss, në të cilin analizohen format e ndryshme të komunikimit që gratë i përdorin përtej diskursit mashkullor dhe të domenit publik.

Një shembull i ngjashëm vjen nga studimi i Helen Sterk, e cila ka analizuar ndër vite eksperiencat e lindjes nga perspektiva e nënës. Problemi që konstaton Sterk është që, edhe pse lindja është një eksperiencë thelbësisht femërore, për shumë gra, procesi i lindjes menaxhohet thjesht në mënyrë mjekësore, duke u dhënë atyre përshtypjen se thjesht po u hiqet diçka nga trupi. Gjuha e përdorur në këtë proces është kryesisht ajo e doktorit. Një proces, i cili reduktohet për mjekun në faktin biologjik se sa centimetër ka arritur dilatacioni i qafës së mitrës. Siç vë re Sterk, për gratë kjo gjuhë është krejtësisht e pamjaftueshme dhe ato i dëgjon të përsërisin vazhdimisht: “thjesht nuk mund ta shpjegoj se çfarë ndjeja!” (Sterk, 90)

Kramarae arrin në konkluzionin se “për të marrë pjesë aktive në shoqëri, grave u duhet t’i

transformojnë modelet e tyre në përshtatje të sistemit mashkullor të të shprehurit.” Si një gjuhë e dytë, ky proces përkthimi kërkon përpjekje të vazhdueshme aplikuese dhe e ruan vazhdimisht të gjallë dyshimin brenda gruas se mos ajo që ka thënë është thënë “ashtu siç duhet”.

Më poshtë po paraqes tre raporte grash të suksesshme shqiptare në lidhje me vështirësitë e tyre për përkthimin e eksperiencave të tyre në gjuhën si produkt i burrave: e para një avokate, e dyta një specialiste e fjalimeve publike dhe e treta dekanë në një universitet.

“kam mësuar të flas si burrë. flas ngadalë, peshoj fjalët, përdor analogji sportive. Kujdesem për paraqitjen, por një grua shumë tërheqëse ose një grua shumë shtëpiake ka një problem. Një burrë mund të jetë yll fare ose i shëmtuar, për të kjo nuk përbën asnjëherë problem. Më kanë thënë që jam avokatja më e respektuar dhe që ma kanë frikën në këtë kompani, por ky nuk është imazhi, me të cilin jetoj çdo ditë. Pas punës kthehem në shtëpi dhe bëj byreçka me vajzën.”

“grave u duhet të përgatiten mirë si në formë ashtu edhe përmbajtje. Unë e theksoj paraqitjen time femërore – bizhuteri, makiazh të fortë, zë të ngrohtë, të ëmbël. Kurse përmbajtjen ia përshtas burrave. Përgatitem me kujdes, e studioj mirë fjalimin, përdor imazhe nga realiteti i burrave. Gratë mësojnë të interesohen për çfarëdo që parapëlqejnë të flasin burrat, kurse burrat nuk janë të mësuar të tregojnë interesim për gjëra që u interesojnë burrave.”

(në mbledhjen e shoqatës kombëtare të dekanëve, ku nga 50 pjesëmarrës, vetëm 8 dekanë ishin gra): *“isha e heshtur. Nuk më pëlqente që isha aty. Nëse nuk komunikon sipas rregullave të burrave, je e padukshme. Folësit kryesorë ishin burra. Askush nuk dëgjonte, gjithkush e kishte mendjen tek prezantimi i vet. I gjithë takimi mbizotërohej nga konkurrenca dhe rivaliteti. Nuk guxoje të thojë “shiko po përjetoj një situatë shumë të vështirë, e keni provuar ndonjë herë?” vetëm kur u bëmë bashkë disa gra, munda ta diskutoja hapur eksperiencën time.”*

Si çdo formë e teorive kritike, teoria e Cheri Kramarae nuk mjaftohet thjesht me konstatimin e asimetrive të pushtetit. Qëllimi final është ndryshimi i sistemit lingistik mashkullor. Sipas Kramarae, reforma duhet të përfshijë fjalorë alternativë që e vendosin gruan në qendër dhe e shohin gjuhën nga perspektiva e saj. Ajo me kolegen e saj Teichler përpiluan një fjalor me 2500 fjalë për të ilustruar kreativitetin lingistik të gruas dhe për të demaskuar në një farë mënyre karakterin mashkullor të gjuhës.

STILI FEMËROR

Teoria e stilit femëror, e sugjeruar fillimisht nga Karlyn Kohrs Campbell dhe e përpunuar më tej nga Bonnie J. Dow dhe Mari Boor Tonn, i shpion më tej përpjekjet e Kramarae për të kuptuar aspektet gjinore të gjuhës.

Sipas teorisë ekziston një stil femëror që lidhet në zanafillë me atë që Campbell e quan *craft learning* (të mësuarit mbi bazën e zejes). (Littlejohn, 118). Me këtë term, Campbell nënkupton jo vetëm "zanatet" tradicionale të gruas që lidhen me qepjen, gatimin, kopshtarinë, por edhe ato emocionale si të ushqyerit, empatinë dhe arsyetimin mbi gjëra konkrete. Campbell sugjeron se, teksa ky stil nuk është ekskluzivisht i grave, ai lindi nga eksperiencat domestikale dhe, si i tillë është më personal në ton. "Një mënyrë e tillë ligjërimi është thellësisht personale (zanatet mësohen ballëpërballë nga një mjeshtër apo këshilltar), e cila mbështetet thellësisht në eksperiencën personale, anekdota e shembuj të tjerë. Kjo mënyrë ligjërimi priret të jetë induktive dhe e strukturuar (zanatet mësohen pak nga pak, rast pas rasti, nga të cilat dalin përgjithësimet). Ajo fton audiencën për të qenë pjesëmarrëse duke përfshirë edhe procesin e verifikimit të përgjithësimeve apo të parimeve karshi

eksperiencave individuale të audiencës.

Anëtarët e audiencës adresohen si të barabartë, ku autoriteti fitohet dhe pranohet mbi bazën e eksperiencës." Njëra nga strategjitë e oratorëve të hershme gra ishte përdorimi i këtij stili për t'u shfaqur më "femërore" në arenën publike dhe gratë vazhduan të mësohen me këtë mënyrë komunikimi që korrespondonte me sferën private tradicionale të gruas.

Bonnie J. Dow dhe Mari Boor Tonn e zgjeruan punën studimore mbi stilin femëror, duke sugjeruar se ky stil mbetet një strategji e suksesshme, me të cilën gratë bashkëkohore përpiqen të kenë akses në sistemin politik. Jane Blankenship dhe Deborah Robson hulumtuan diskursin publik të grave midis 1991 dhe 1994 për të verifikuar nëse mund të thuhet se ekziston një stil femëror në ligjërimin publik. Përfundimi i studimit të tyre pranon se ekziston në fakt një stil i tillë që karakterizohet nga 5 cilësi: 1) përvoja konkrete si bazë për gjykimin politik; 2) përfshirja dhe bashkimi; 3) zyra publike si vend "për të kryer punë"; 4) një qasje holistike në krijimin e politikave; 5) nxjerrja në plan të parë e legjislacionit të grave. Sipas Blankenship dhe Robson mbetet për t'u parë nëse stili femëror bën apo reflekton një diferencë në procesin e politikës publike.

REFERENCA

- Foss, Karen, A. & Foss, Sonja, K. (1991). *Women Speak: The Eloquence of Women's Lives*. Long Grove, Illinois: Waveland Press.
- Griffin, Emm, A. (2012). *A First Look at Communication Theory*. New York, NY: McGraw Hill.
- Kramarae, Cheri. (2005). *Muted Group Theory and Communication: Asking Dangerous Questions*. *Women & Language*, 28(2), 55-61.
- Littlejohn, Stephen, W. & Foss, Karen, A. (2008) *Theories of Human Communication (9th Ed.)*. Thomson Wadsworth.
- Sterk, Helen (1999). *Who's having this baby?: Perspectives on birthing*. Michigan University Press.

Is the new media new?

ALFRED LELA, PhD (c)

Lektor, Departamenti i Komunikim, Marrëdhënie Publike, Universiteti Europian i Tiranës



ABSTRAKT

In Albania, the use of the term 'new media' is novel. Actually, the adjective 'new' is not very much liked and instead the term 'online' is often used. This, of course, has to do with the fact that internet penetration in Albania occurred relatively late, but also with the slow satiation with information through traditional means and communication channels, such as television, newspapers, and radio. The media landscape changed when additional internet providers entered the market, including the mobile telephone companies and the 4G network.

This article is not concerned with internet penetration in Albania, or defining 'new media' and 'online media', but rather to address the question is 'new media' new? Does it offer only a new communication platform, an additional instrument, more efficient, faster and more tangible, and just that, or is there a new communication quality, a different narrative and, maybe, there is a possibility of change? A case study of former Prime Minister Sali Berisha can be used to show that communication has not changed in essence, but only in form. Mr. Berisha now delivers most of

his political speeches through a new media: his official Facebook page.

Keywords: new media, traditional media, Facebook, communication, context

Entry

Sali Berisha is very proud of his high-tech communication gear. During plenary sessions of Parliament, he always takes his iPad with him, and even holds it up when speaking from the Assembly's podium or during interviews with journalists, as if to give more power to an argument. He often refers to his iPad; you can even find it listed under "Interests" on his official Facebook page.

This is not Mr. Berisha's only technological 'triumph': his official Facebook page has the highest number of followers among Albanian politicians, leaving behind the two younger ones: Lulzim Basha, the current head of the Democratic Party, and Edi Rama, the country's Prime Minister (the other prominent politician, Speaker of Parliament Ilir Meta, does not have a Facebook page or Twitter account). Mr. Berisha, despite his age and a certain perception about his generation's clumsiness when it comes to social networks, has one of the most followed pages, even compared with the young

celebrities, including here the likes of Ermal Mamaqi, Genta Ismajli, and Elvana Gjata. Since Mr. Berisha is a political figure, and has lead the country for half of the 25-year post-communism period, his profile in the typology 'new media' should be a case study on its own. This, not only because his relationship with the traditional or mainstream media has been very different from the aforementioned people, but also because politics and media in regard to each other have other specifics. One of them is noted by the scholar Ardian Vehbiu:

Pluralism in Tirana has always leaned on the side of segmentation, in the sense that parties, or social poles, have imposed on all sectors, including that of communication, a feudal model of dividing into plots, according to area of influence and political support. It has been in the direct interest of political elite to control the media, even in those cases when the opposing party is in control; because oligarchies prefer polarization to independence, in the sense that they want to make sure that they are standing face-to-face with their enemy, not the public opinion as such.

This observation of Mr. Vehbiu that Mr. Berisha moved his political "speeches" to Facebook in the second half of his second mandate as Prime Minister of Albania, explains Mr. Berisha's withdrawal from one of the main communication forums --Blendi Fevziu's talk show *Opinion*. Mr. Berisha never made public the reasons behind the alienation from one of *Albania's main political debate arenas*, but his absence from 'Opinion' and his appearances at the studio of Mr. Fevziu's direct rival, Sokol Balla's Top Story, provides the answer.

Where Mr. Berisha shined with his absence, was beaming the outline of friendship gone 'sour', even though the motives were never made known. In the dark on these motives was also the journalist Blendi Fevziu, who, in an interview for the daily 'Panorama', said that he didn't know why Mr. Berisha did not prefer his studio anymore.

Mr. Berisha became more active on Facebook, especially following his defeat in the June 2013

elections, when he also resigned as chairman of Democratic Party of Albania. The former leader of opposition and former Prime Minister became a "Facebook oppositionist" with his daily status updates. Each one of them was reported by the traditional media, erasing the borders between the new and old media. On top of this, the former Prime Minister, with a fluctuating periodicity, holds press conferences with the reporters of traditional media, but it's safe to say that Facebook is his daily newspaper, radio, and television. From Facebook, he 'addresses the nation'. On Facebook, Mr. Berisha is still Prime Minister and chairman of opposition.

DOES THE NEW MEDIA EXIST?

The example of former Prime Minister Berisha, is analogous to the observation of Angela Phillips, who characterizes the new media as the same ole' the post-modern communication -- *old sources with new bottles*.

What Phillips is trying to say is relevant with what has happened and is happening in Albania, just like in the rest of the world -- The narrative of what is being said has not changed, and neither has the chronicler who says it. The only difference is that now they have moved to a new window from where they speak. We are dealing with a new bottle (Facebook, Twitter, etc), but the sources of narrative are the same (Sali Berisha, Edi Rama, Donald Trump, etc)

This is not only the case of what can be called *brand new media* (i.e., social networks similar to Facebook), but also of the *new media* (internet or online sites of traditional media).

Ardian Vehbiu says: Albanian online media, even though a little late in comparison with their sisters (in the west-author's remark), were created from the beginning as extensions of traditional media—in the sense that existing newspapers and magazines purchased web space and started placing or uploading there, in essence, the same materials that were being published in print, only that this time they were available for the reader free of charge.

It looks like we are in a paradoxical situation: the new media has arrived but they have not changed much. At least in Albania, the sites of traditional media have transformed into the new media by going online, but by using the old tools and the same team of journalists.

According to a study of Albanian Institute of Media, the sites of traditional media are more popular than those created recently. Mr. Berisha's case, of a dinosaurs' transcendence into the new planet of Facebook while the narrative remains the same illustrates this.

Lisa Gitelman and Geoffrey Pingree argue that "all media were once new media." Here we should add that classification of postmodern forums as "new media" means that the previous are "old". Still, many examples show that the discovery of New Media is more or less like arriving in the New World: the territory is new, but those walking on it, populating it and filling it with old and new rituals are the same.

Ardian Vehbiu continues: *Even the unprecedented blooming of social networks, blogs, online forums and pages of comments has prove, and continues to prove, paradoxically, that all of WEB 2.0's rich and diverse productivity can't give a sustainable value, independent of the traditional media--or of those magic spaces where the raw information is intermediated and processed.*

As for the Albanian case, another scholar of communication, Ermal Hasimja, uses the terms 'democratic context' and 'authoritarian context', alleging that the latter has triumphed at the expense of the former. Thus, new media have added noise, participation, and the illusion of democracy, but they have not facilitated, let's say, an *Albanian Spring* in communication. There is not one case in Albania where the new media has been used for the same goals as Facebook and Twitter were used in the case of the *Arab Springs* – to bring a change or a new social context.

CONCLUSION

A simple search in the platform itself (at the section dedicated to creating ads for the Albanian audiences) showed that number of Facebook users in the beginning of 2015 was nearly 1 340 000 people. Of these, 860 000 were males, and 480 000 females.

At first glance, the fact that in Albania the number of male Facebook users is twice that of females seems 'innocent'. But it's not like that. The concept used by the scholar Hasimja for 'authoritarian contexts' is, among other things, also explained with this fact, in appearance unrelated to "great things". Also, as it is explained by the patriarch social context, and so forth. The sad conclusion is that new media are, in fact, new technologies in form, but in content they are the old.

The aforementioned examples illustrate this point of view. Is this the fading of great expectation, or simply a link in the long and old chain of social and technological processes? Both. In any case, lost is the illusion that the new media would serve as a cure for the old communication maladies.

REFERENCES

- Gitelman, Lisa and Pingree, Geoffrey B, *New Media 1740–1915* (Cambridge: MIT, 2003, xi–xxii).
- Kyong, Hui Wendy & Keenan, Thomas (editors), 2006, *New media, old media-a history and theory reader*, Routledge.
- Jenkins, Henry, 2006, *Convergence culture-where old and new media collide*, New York University Press.
- Phillips, Angela, 2010, *New media old news*, Sage.
- Gazeta Panorama, 22 mars 2015, Blendi Fevziu: Berisha nuk ma shpjegoi pse e prishi miqësinë.
- Vehbiu, Ardian- Etika e mediave në epokën e digjitalizimit, Instituti Shqiptar i Medias.
- Instituti Shqiptar i Medias, studim: Zhvillimi i internetit dhe i mediave sociale në Shqipëri, 2015, Tiranë.
- Hasimja, Ermal, *Revolucioni i humbur: Mediat e reja dhe aktivizmi*, studim, Instituti Shqiptar I Medias.
- Berisha, Sali, faqja zyrtare Facebook (interests).

Funksioni i mediave të reja në promovimin e “grupeve të vogla”

LORENA LICENJI, PhD

Lektor, Departamenti i Komunikim, Marrëdhënie Publike, Universiteti European i Tiranës



ABSTRAKT

Mediat e reja, dhe në veçanti rrjetet sociale mund ti konsiderojmë një instrument të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik. Përgjatë këtij punimi do të evidentohen problematikat dhe vështirësitë e hasura nga komunitetet e marginalizuara për të siguruar akses në median tradicionale dhe mundësitë e reja që krijohen për këto komunitetet të cilat falë përdorimit të rrjeteve sociale mund të promovojnë kulturën, traditën dhe vlerat e tyre.

Nisur nga ky këndvështrim, punimi synon të analizojë, nëpërmjet analizës cilësore, mundësitë që ofron interneti në përgjithësi dhe rrjetet sociale në veçanti në aktivizimin dhe promovimin e grupeve të vogla në nivel lokal dhe rajonal.

Njëkohësisht, punimi synon të shqyrtojë dhe evidentojë mënyrat nëpërmjet të cilave këto grupe sigurojnë vizibilitet për çështje të veçanta. Si mund të tejkalohen vështirësitë e hasura nga këto grupe në promovimin e tyre nëpërmjet mediave të reja?

Hipoteza e këtij punim është që përfaqësimi në media mund të ndihmojë në njohjen e grupeve dhe komuniteteve të ndryshme dhe në

krijimin e nje opinionit publik të mirëinformuar mbi problematikat dhe shqetësimet e këtyre grupeve.

Fjalët kyçe: Media, Opinion publik, Rrjetet Sociale, Grupet e vogla.

HYRJE

Shpejtësia me të cilën teknologjitë e komunikimit dhe informacionit i janë përshtatur ndryshimeve dhe kërkesave të sektorëve të ndryshëm të shoqërisë, cilësohet si e paprecedentë në historinë e civilizimit (Bentivegna, 2002). Në kushtet e zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, mediat e reja kanë zënë një vend të rëndësishëm në informimin e shoqërisë shqiptare. Fillimisht sistemi mediatik, dhe më pas interneti, ka kontribuar në krijimin dhe kultivimin e raporteve shoqërore. Media ka luajtur, dhe do të vazhdojë të luajë, një rol të rëndësishëm në procesin e socializimit dhe në pasqyrimin e çështjeve të rëndësishme për opinionin publik.

Çështja që ngrihet për diskutim në këtë punim është funksioni që mund të ushtrojnë mediat e reja në përgjithësi, dhe rrjetet sociale në veçanti, në promovimin e grupeve të vogla dhe

të marginalizuara siç janë komuniteti Rom dhe Egjiptian në Shqipëri.

Duke marrë parasysh rëndësinë e organeve mediatike të shtypit dhe të medias elektronike në shoqëritë e sotme, si dhe ndikimin e tyre në formësimin e opinionit publik, rezulton si e qënësishme edhe influenca që këto organe mund të kenë në procesin e vendimmarrjes politike.

Në këtë punim do të analizojmë rastin e përfaqësimit në rrjetet sociale të dy komuniteteve nëpërmjet shoqatave dhe grupeve të krijuara për mbështetjen e tyre, si dhe do të analizohet niveli i përfaqësimit të tyre në media, dhe në veçanti aksesin që ka pasur në media Partia për Europianizim dhe Integrim, si përfaqësuese e komunitetit Egjiptian dhe Rom në zgjedhjet lokale 2015.

Studimet e kryera nga institucionet ndërkombëtare kanë evidentuar problematika dhe vështirësi të shumta, të hasura nga komunitetet e marginalizuara, për të siguruar akses në median tradicionale. Për këtë arsye, përdorimi i rrjeteve sociale do të mund të krijojë mundësi të reja për të promovuar kulturën, traditën dhe vlerat e këtyre grupeve.

Falë potencialit të ofruar nga interneti, i cili lehtëson komunikimin e grupeve të vogla dhe të marginalizuara me pjesën tjetër të shoqërisë, edhe këto komunitete mund të përfshihen me të drejta të barabarta në strukturën e komunikimit masiv.

Proçesi i komunikimit mund të ndihmojë në njohjen e grupeve apo komuniteteve të ndryshme, ashtu sikurse ndihmon në krijimin e një opinionit publik të mirëinformuar mbi problematikat dhe shqetësimet e këtyre grupeve. Mediat e komunikimit masiv do të mundësojnë vendosjen e një marrëdhënie këtyre popujve dhe kulturave.

Nisur nga ky këndvështrim, mjetet e reja të komunikimit mund të konsiderohen si instrumente të cilat mund të japin kontributin e tyre në zgjidhjen e problematikave politike, sociale, ekonomike.

Nëse do i referohemi qasjes që sistemi mediatik shqiptar ka pasur ndaj grupeve të vogla, në rastin e marrë në studim, ndaj komunitetit Rom dhe atij Egjiptian, përfaqësimi në media,

referuar studimeve të shoqatave ndërkombëtare të cilat operojnë në Shqipëri, rezulton në nivele të ulëta dhe karakterizohet nga tone negative dhe paragjyquese.

Në këtë kuadër, për të analizuar funksionet që mund të kryejnë mediat e reja dhe rrjetet sociale, do të merret në analizë roli i rëndësishëm i luajtur nga lideri i opinionit në këto grupe, rol i cili mundëson ndërmjetësimin midis grupit të tij të përkatësisë dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

PËRFAQËSIMI POLITIK DHE MEDIATIK I “GRUPEVE TË VOGLA”

Romët dhe Egjiptianët janë dy nga grupet më të varfëra dhe më të marginalizuara në Shqipëri. Përjashtimi social konsiderohet si shkak kryesor i varfërisë dhe i nivelit të ulët ekonomik të këtyre komuniteteve.

Pavarësisht faktit që Shqipëria bën pjesë në vendet me dëndësi më të madhe mediatike, rezulton se nuk ka një mbulim sistematik, të rregullt, të paanshëm, të problemeve apo çështjeve që prekin këto komunitete.

Studimet konstatojnë se struktura mediatike shqiptare ka përparuar në përpjekjet e saj për tu ofruar shanse të barabarta grupeve të marginalizuara, por duke ju përshatur logjikës mediatike media fokusohet më shumë në përfaqësimin e grupeve të shumicës.

Për të kuptuar arsyet e mospërfaqësimit të plotë të këtyre komuniteteve në median gjeneralistë na vjen në ndihmë përkufizimi i Bourdieu mbi televizionin dhe gazetarinë. Një ndër arsyet kryesore sipas Bourdieu, mund të jetë pikërisht rëndësia që i kushtohet lajmeve sensacionale dhe pseudoeventeve. Komercializimi i hapësirave publike është ajo që “justifikon” vëmendjen e kushtuar ndaj grupeve të vogla, veçanërisht si pjesë e lajmeve të kronikës së zezë (Bourdieu, 1997). Imazhi negativ i minoriteteve, i transmetuar në media, kontribuon në nxjerrjen në pah më shumë të stereotipeve dhe në rritjen e diskriminimit. Duke ju referuar teorise së Elisabeth Noelle-Newmann, opinionet që media i shfaq si dominante bëhen të tilla në të vërtetë duke bërë që publiku të jetë pasiv dhe

i pa interesuar për çështje që nuk e prekin në mënyrë të drejtëpërdrejtë (Noelle-Neumann, 2002).

Pavarësisht faktit që pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë qënë anëtarë të partive të ndryshme politike, deri në zgjedhjet lokale të 2015 atyre u ka munguar përfaqësimi i drejtëpërdrejtë në strukturat politike, përfaqësim i cili do të mundësonte mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë e rregjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet lokale të 2015, si përfaqësuese e komunitetit Egjiptian dhe Rom në Shqipëri, ka pasur si objektiv të saj adresimin e problemeve sociale dhe kulturore në organet e politikëbërjes. Një ndër elementët karakterizues të kësaj partie ka qënë fakti që gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të 2015, ka përdorur gjërësisht teknologjitë e reja të komunikimit, në mënyrë specifike rrjetet sociale, me synim përforcimin e pjesëmarrjes politike të anëtarëve të këtij komuniteti dhe shpërndarjen e programit elektorale. Interneti është konsideruar si një alternativë komunikimi me pjesën tjetër të shoqërisë, por vlen të theksohet edhe fakti se rrallë herë është mundësuar kontakti i drejtëpërdrejtë me qytetarët për shkak të pamundësisë për të pasur akses në internet. Funkcioni i ndërmjetësuesit midis rrjeteve sociale dhe pjesës tjetër të komunitetit, e cila has vështirësi në përdorimin e këtyre instrumentave, është kryer nga 1200 studentë anëtarë të partisë dhe përfaqësues të këtyre komuniteteve, të cilët kanë kryer funksionin e liderit të opinionit dhe të transmetuesit të informacionit. Këta studentë identifikohen si lider opinionit informalë të cilët ushtrojnë më shumë ndikim tek komuniteti i tyre. Liderët e opinionit në këtë rast kanë pasur mundësi të ndikojnë në ndërgjegjësimin e opinionit publik, dukë bërë të mundur që të stimulojnë reagimin e qeverisë ose autoriteteve përkatëse.

Nëse do të aplikojmë konceptin e opinionit publik dhe ndikimin e tij në këto komunitete, mund të konstatojmë se formimi dhe qarkullimi i një opinionit publik kushtëzohet nga interesat vetjake të individëve të cilët janë të interesuar për një çështje. Rezulton se këto komunitete

bëhen pjesë e opinionit publik nëse ata preken nga çështje të caktuara.

Sipas Brian McNair, aktorët politikë të margjinalizuar, janë në disavantazh në lidhje me partitë kryesore politike, me qeverinë dhe me institucionet zyrtare. Pikësëpari, kësaj force politike i mungojnë burimet financiare dhe "kapitali kulturor". Sikurse risillet në veprën e Stuart Hall, ekziston një akses i strukturuar dhe i diferencuar në media duke favorizuar grupet që janë në pozicione dominante dhe duke diskriminuar grupet e vogla ose anësore. Pikërisht për vetë faktin që grupet e vogla nisen nga një pozicion i varfër në burime financiare dhe kulturore, që të mundësojnë aksesin në media, këto grupe duhet të zgjerojnë strategjitë e menaxhimit të medias dhe duhet të shfrytëzojnë më profesionalizëm mundësitë e ofruara nga teknologjitë e reja.

Nisur nga kjo pikëpamje duhet të kemi parasysh faktin se aksesi në media nënkupton mundësi për të përcaktuar problemet dhe për të qënë pjesë e axhendës mediatike dhe debatit publik (McNair, 2009, 158).

Studiuesit bashkëkohorë konstatojnë se falë avantazheve dhe lehtësive në përdorimin e tij, përhapja e internet është pritur me entuziazëm si nga audienca e gjerë ashtu edhe nga subjektet politike (Baylon, & Mignot, 2005, 305). Pikërisht, për këtë arsye fenomeni i mediave sociale është transformuar në një praktikë profesionale dhe objekt të lakmuar studimi nga akademikët e fushës.

Këto studime vënë theksin tek fakti që, pikërisht nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale, si një nga format më të preferuara të komunikimit në internet, si nga politikanët ashtu edhe nga qytetarët, ridimensionohet roli i luajtur nga televizioni dhe mediat e tjera tradicionale në formësimin e opinionit publik (Castells, 2009). Mbulimi mediatik duhet të luajë një funksion të rëndësishëm në përfaqësimin e komuniteteve të margjinalizuara

Në shqipëri rezulton se strukturat e aksesit në media karakterizohen nga një nivel i ulët elasticiteti dhe nuk mundësojnë praninë e grupeve të vogla. Nga studimet e kryera rezulton mungesa e hapësirës së nevojshme për trajtimin mediatik të profilit historik dhe social të

këtyre komuniteteve.

Megjithëse në përgjithësi media është treguar dashamirëse me komunitetin rom, ajo duhet t'ujapë më shumë prioritet problemeve të ndryshme që ka shfaqur ky komunitet në Shqipëri. Mungojnë kronika, emisione me karakter social-ekonomik, ndërsa problemet e strehimit, papunësisë, arsimit, trafikimit të fëmijëve janë trajtuar rrallë.

MUNDËSITË E OFRUAR NGA RRJETET SOCIALE NË PROMUOVIMIN E GRUPEVE TË VOGLA.

Interneti shërben si shprehje individuale dhe e grupit. Ky rrjet mundëson shkëmbimin e informacionit duke ndikuar në pluralizimin e hapësirës publike.

Çështja që ngrihet për diskutim në këtë punim është si si grupet e vogla mund të përdorin teknologjitë e reja të komunikimit për të mundësuar një përfaqësim më të denjë dhe të ekuilibruar në hapësirën mediatike shqiptare. Aksesit i shqiptarëve në internet ka ardhur në rritje. Sikur mund të shihet edhe nga tabela e mëposhtme, konfirmohet një rritje e tendencës ndër vite për përdorimin e internetit. Përdoruesit e internetit në vitin 2011 arrijnë shifrën e 1,3 milion banorëve dhe 1,05 milionë prej tyre janë përdorues të rregullt të facebookut. Ashtu sikurse ilustron edhe në tabelën e mëposhtme, në fillim të vitit 2011 rezultonte 43,5% popullata që kish mundësinë e përdorimit të internetit shifër që në vitin 2014 arrin në 60,10% të popullsisë.

Në vitet e fundit, një rritje të shpejtë ka patur edhe në numrin e mediave online, blogjeve, si dhe portaleve të ndryshme. Statistikat gjithashtu tregojnë se falë përhapjes në rritje të internetit, gjithnjë e më shumë shqiptarë i ndjekin lajmet në variantin on line.

Akoma në shqipëri nuk ekzistojnë shifra për sa i përket përdorimit të internetit nga grupet e marginalizuara, por nëse i referohemi shifrave mbi mungesën e arsimit dhe të papunësitimit popullsia romë ka nivelin më të lartë të analfabetizimit dhe nivelin më të ulët arsimor. Mediat sociale dhe mjetet e tjera për të forcuar

rrjetin e lidhjeve, mund të rrisin praninë në sferën publike dhe të shërbejnë si mjete për të përcjellë mesazhe dhe për të paraqitur të dhëna lehtësisht të aksesueshme, por nuk mund të mos përmendet fakti që statusi i tyre social dhe ekonomik bëhet pengesë për akses në informacion. Media duhet të luajë një rol kyç në ndryshimin e stereotipeve dhe në krijimin e një opinion publik të mirëinformuar mbi problematikat e këtyre komuniteteve.




Fig 1. Numëri i përdoruesve të internetit për 100 banorë. *Burimi:* Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve

Studimet tregojnë se përfshirja e këtyre grupeve në politikbërje mund të ndikojë pozitivisht në fuqizimin e tyre dhe në përmirësimin e politikave publike apo shërbimeve.

Për Castells, shoqëria aktuale ndërtohet nëpërmjet rrjeteve, dhe nëpërmjet rrjeteve mund të prodhohen efektet e dëshiruara ashtu sikurse mund të jetë ulja e nivelit të diskriminimit. Përdorimi i internetit mundëson krijimin e hapësirave të reja për një pjesëmarrje më të gjërë në sferën publike. Shpesh herë komunitetet e vogla mund ta përdorin hapësirën e krijuar nga rrjetet sociale për të riorganizuar komunitetin e tyre dhe për të ndërtuar marrëdhënie me aktorë të tjerë të rëndësishëm.

Një element i rëndësishëm që rezulton nga analiza e faqes facebook të Partisë për Europeanizim dhe Integrim, është fakti që edhe pse postimet e fjalimeve, intervistave, programeve janë të shpeshta ka një pjesëmarrje të ulët të komentuesve.

Përdorimi i rrjeteve sociale favorizon krijimin e një kontakti të drejtpërdrejtë midis politikanit dhe publikut, qytetarëve të thjeshtë u mundësohet pjesëmarrja aktive në debatin

publik dhe politik. Mundësohet vetëpërfaqësimi i aktorëve politikë si dhe informacionet politike mund të shumohen dhe të ripërtërihen në hapësirë dhe në kohë, gjithashtu krijohet një hapësirë e re diskutimi për çështje të interesit publik.

KONKLUZIONE

Ajo që konstatojmë nga punimi i mësipërm është impakti pozitiv që mund të ushtrojë mediat e reja në promovimin e grupeve të vogla të marginalizuara. Nëpërmjet krijimit të mundësive për akses në këto media, komunitetet e vogla do të mund të sigurojnë pjesëmarrje të plotë në jetën sociale, politike, kulturore.

Nga analiza e literaturës rezulton se përfaqësimi në media i komunitetit Rom dhe Egjiptian është në nivele të ulëta dhe karakterizohet nga tone negative dhe paragjykuese. Imazhi negativ i minoriteteve i transmetuar në media kontribuon në nxjerrjen në pah më shumë të stereotipeve dhe në rritjen e diskriminimit.

Një element i rëndësishëm që del në pah në këtë analizë është edhe fakti që këtyre grupeve u ka munguar përfaqësimi i drejtëpërdrejtë në strukturat politike deri në vitin 2015 kur është zyrtarizuar Partia për Europeanizim dhe Integrim e cila ka përcaktuar si objektiv të saj adresimin e problemeve sociale, ekonomike, kulturore të këtyre komuniteteve në strukturat e politikbërjes shqiptare.

Një tjetër faktor që haset nga kjo analizë është pamundësia e këtyre grupeve për të qënë pjesë e axhendës mediatike dhe debatiti publik. Nisur nga fakti që grupet e vogla karakterizohen nga mungesa e burimeve financiare dhe kulturore këto grupe duhet të shfrytëzojnë më shumë mundësitë e ofruara nga zhvillimi i teknologjive të reja.

Në rastin e marrë në studim Partia për Europeanizim dhe Integrim, përfaqësuese e dy komuniteteve gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ka shënuar një prezencë aktive dhe konstante në rrjetet sociale. Funksioni i

ndërmjetësuesit midis rrjeteve sociale dhe pjesës tjetër të komunitetit është kryer nga 1200 studentë, anëtarë të këtyre komuniteteve të cilët kanë kryer funksionin e liderit të opinionit dhe transmetuesit të informacionit nga media tek votuesit e komunitetit të tyre.

Nëpërmjet mundësisë së aksesit në media nga komunitetet e marginalizuara, falë mënyrave të ndryshme të zgjedhura nga këto komunitete për tu përfaqësuar në publik, shoqëria shqiptare do të ketë më shumë hapësira për tu informuar dhe njohur me historinë, kulturën dhe problemet që has kjo pjesë e shoqërisë.

REFERENCAT

- Albanian Media Institute & Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, 2014. "Raport vlerësimi i mbulimit të grupeve vulnerabël në median shqiptare", Tiranë.
- Banka Botërore, 2010, «Roma Inclusion: An Economic Opportunity for Bulgaria, Czech Republic, Romania and Serbia», Shtator, Tiranë.
- Baylon, C. & Mignot, X. (2005), *La Communication*. Paris, Colin.
- Bentivegna, S. (2002), *Politica e nuove tecnologie della comunicazione*, Roma-Bari, Laterza.
- Bettetini, G. & Garassini, S. & Gasparini, B. (2001), Vittadini N, *I nuovi strumenti del comunicare*, Milano, Bompiani.
- Council of Europe, (2011), *Të Drejtat e Romëve dhe të Komuniteteve Shtetgare në Europë*.
- Lippman, E. (2004), *L'opinione pubblica*, Roma, Donzelli.
- Londo, I. (2004), *Media ownership and its impact on media independence and pluralism*, June, Ljubjana.
- Open Society Institute EU Monitoring and advocacy program netëork media program. *Televisioni ne Europe*. Rregullimi, politikat dhe pavaresia, Tirane, 2005.
- Open Society Foundation for Albania, *Përdorimi i Facebook, Tëitter, YouTube dhe Blogjeve për ligjërim politik mes të rinjve dhe kandidatëve për bashki e komuna* (Use of Facebook, Tëitter, YouTube, and Blogging for political deliberation betëeen the youth and candidates for local office).
- PNUD, *Prekshëmëria shoqërore e romëve*, Tiranë, 2006
- Romano, O. (2000), *Albania, alla ricerca di nuovi equilibri*, in S. Matteucci (a cura di) *Gli altri Balcani*. *Associazione, media indipendenti e intellettuali nei paesi balcanici*, Trieste, Asterios Editore.

Fuqizimi i të rinjve rom përmes medias alternative

BLERJANA BINO, PhD (c)

Drejtor Ekzekutiv, Qendra UET

Lektore, Departamenti i Komunikimit dhe Marredhenie Publike, UET



NJË PROJEKT PËR SKAJIMIN MEDIATIK TË KOMUNITETIT ROM

Studimet tregojnë se mënyra sesi portretizohen grupet e skajuara në median masive (televizioni, gazetat kryesore) riprodhojnë dhe ripërforcojnë skajimin dhe deprivimin e tyre. Projekti në fjalë është i motivuar nga rezultatet e kërkimeve të mëparshme të Qendrës UET lidhur me rolin e mediave alternative dhe gjithëpërfshirjen shoqërore të grupeve të skajuara dhe i mbështetur nga Fondacioni ABC. Këto kërkime sugjerojnë se grupet e skajuara duhet të ndërtojnë mediumet e tyre të komunikimit për të shprehur zërin, perspektivat dhe interpretimin e tyre për botën si dhe për tu bërë kështu pjesëmarrëse në proceset e politikëbërjes përmes një mediumi alternativ dhe jo atyre dominuese në sistemin mediatik aktual. Bazuar në këtë kuadër, ky projekt synon të adresojë një dimension më pak të trajtuar deri më tani përmes programeve të ndryshme ndërhyrëse, pra, dimensionin e skajimit mediatik të komunitetit Rom.

Projekti adreson një nga sfidat kryesore të gjithëpërfshirjes shoqërore të grupeve të skajuara sikurse është nevoja për të krijuar dhe zhvilluar hapësira komunikuese pjesëmarrëse

alternative për këto grupe. Projekti ndalet në veçanti tek komuniteti Rom në Shqipëri dhe skajimi i tyre mediatik i cili lidhet me skajimin social, kulturor, politik dhe ekonomik. Aktivitetet e projektit përfshijnë: (i) vlerësimin e nevojave të komunitetit Rom për hapësira komunikuese alternative dhe pjesëmarrëse; (ii) ndërtimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve për të zhvilluar hapësirat komunikuese alternative dhe pjesëmarrëse; (iii) trajnimin e të rinjve elitar Rom për ndërtimin e mediave alternative për t'iu kundërvënë skajimit.

MEDIAT ALTERNATIVE SI INSTRUMENT PËR T'IU KUNDËRVENË SKAJIMIT

Në politikëbërje, në programet e shoqërisë civile si edhe në kërkimin shkencor, skajimi i grupeve të caktuara përfaqet më tepër dhe kryesisht në terma të dimensionit social, ekonomik dhe ligjor të fenomenit, të lidhura këto ngushtë me të drejtat e njeriut dhe gjithëpërfshirjen shoqërore. Ky dokument përqendrohet në mënyrë të veçantë tek krijimi i hapësirave komunikuese pjesëmarrëse alternative për grupet e skajuara. Studimet tregojnë se mënyra sesi portretizohen grupet e skajuara në median

masive konvencionale (radio, television, gazeta) riprodhojnë dhe ripërforcojnë skajimin dhe deprivimin e tyre (Atton, 2002). Andaj, mediat alternative konsiderohen si mbartëse të potencialit për të *'krijuar hapësira të reja për zërat alternativë duke ofruar kështu hapësirë për interesat e komuniteteve të veçanta, për të ndryshmen dhe për të skajuarën'* (Silverstone, 1999: 3)¹. Këto hapësira komunikuese e pjesëmarrëse të mundësuar nga mediat alternative dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit ofrojnë mundësi për grupet e skajuara që të kenë akses bazuar në termat e tyre specifik të përcaktuar prej tyre dhe jo sipas 'rregullave të lojës' së shoqërisë dominuese. Mediat alternative si një term që përshkruan të gjitha formatet e mediave të cilat nuk janë tradicionale, konvencionale apo të rrymës kryesore në sistemin mediatik. Në këtë kuptim me media alternative mund të kuptojmë gjithçka që *nuk gjejmë tek 'gazeta shitësi' apo 'programi i radios dhe televizionit'*. Ndërsa mediat e reja lidhen ngushtë me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, mediat alternative janë më gjerë sesa aq dhe mund të përfshijnë edhe radio, edhe gazeta, edhe TV, përsa kohë që në përmbajtje, organizim, dhe shpërhapje nuk janë njësoj si mediat konvencionale. Përkufizimi i mediave alternative mund të bëhet në lidhje me kapacitetin e tyre për të gjeneruar metoda jo standarde të krijimit, prodhimit dhe shpërndarjes së lajmit/përmbajtjes si dhe të përmbajtjes së mesazheve të tyre (Atton, 2002)². Kështu mediat alternative ofrojnë mjetet për komunikim demokratik për ato grupe apo individë të cilët janë normalisht të skajuar apo përjashtuar nga prodhimi mediatik. Mediat alternative duhet të bëhen të disponueshme për qytetarin e thjeshtë,

pa pasur nevojë për kualifikim profesional, pa kapital financiar, dhe duhet të organizohen në vende të tjera jashtë institucioneve mediatike masive apo sistemit mediatik dominues (Downing, 2001)³. Kështu rolet dhe përgjegjësitë në mediat alternative nuk janë qartësisht të ndara, ka shumë mbivendosje dhe transformime të nocioneve të tilla si: profesionalizëm, kompetenca dhe ekspertizë.

Portretizimi dhe përfaqësimi i grupe të caktuara në shoqëri në median masive bëhet nga grupet elitare dhe të favorizuara në shoqëri dhe si i tillë riprodhon status-quo-në e grupeve të skajuara, të cilat rallë herë janë pjesë e elitës kulturore, politike dhe ekonomike që ka akses në median masive dominuese. Këto grupe shoqërore janë të çfuqizuara dhe të skajuara nga mënyra sesi portretizohen dhe përfaqësohen në median masive. Arsyet mund të lidhen edhe me mënyrën si krijohet/raportohet lajmi në mediat masive si rutina komplekse pune në prodhimin e lajmeve, kushtet e prodhimit, profesionalizmi dhe kultura e objektivitetit apo e mediave partizane, përgatitja dhe editimi, etj. Gjithashtu një tjetër dimension i arsyeve të këtij portretizimi është edhe ai i racizmit dashamirës të shoqërisë masive dhe të ligjërit në sferën publike. Media alternative i përgjigjet këtij portretizimi dhe përfaqësimi të grupeve të skajuara në median masive dominuese duke prodhuar vetë lajme apo hapësira komunikuese, bazuar në: vlera alternative nga ato dominuese dhe në një tjetër kuadër të mbledhjes, shkrimit dhe raportimit të lajmit. Këto vlera burojnë nga dëshira për të prodhuar interpretime të tjera të historisë apo ngjarjeve dhe për të prezantuar në media ato ndodhi që normalisht nuk do të përbënin 'lajm', të cilat ndyshojnë atë hierarkinë ekzistuese të aksesit dhe publikimit të lajmit që ndodh në median masive.

HAPËSIRA KOMUNIKUESE ALTERNATIVE DHE PJESËMARRËSE PËR KOMUNITETIN ROM

Në kuadër të projektit u realizuan dy fokus grupe me pjesëtarë të komunitetit Rom. Takimi me pjesëtarët e komunitetit, nëpërmjet fokus

¹ Për më tepër për rolin e mediave alternative kundër skajimit, Bino, B. (2014) 'T'i kundërvihesh skajimit përmes ligjërit: Mundësitë dhe kufizimet e sferës publike', Albanian Studies Days Proceedings, UET Press. Bino, B. (2014) 'Countering marginalization and discrimination through the production of alternative discourses in the public sphere: The case for a 'Roma Community Radio' in Albania', Slovak and Balkan Public Policy Fund Joint Publication, pp. 81-114. http://www.balkancsd.net/images/Non-majority_Communities.pdf

² Për më tepër për rolin e mediave alternative kundër skajimit, Bino, B. (2014) 'T'i kundërvihesh skajimit përmes ligjërit: Mundësitë dhe kufizimet e sferës publike', Albanian Studies Days Proceedings, UET Press.

³ Ibid.

grupeve ishte parashikuar si pjesë e fazës së parë të projektit, me qëllim mbledhjen e perspektivave të komunitetit dhe sidomos të rinjve lidhur me nevojat e tyre mediatike. Gjithashtu, përmes focus grupeve u mbledhën mendime rreth mënyrës së përfaqësimit të komunitetit në medias masive konvencionale dhe sesi mediat alternative dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit po ndikon në krijimin e hapësirave të reja të komunikimit për të rinjtë Rom. Takimet u zhvilluan në dy ditë të ndryshme dhe takimi i parë u mbajt më datë 6 Nëntor 2014, ndërsa i dyti me datë 12 Nëntor 2014, pranë Universitetit European të Tiranës. Në secilin prej tyre krahas anëtarëve të komunitetit Rom, morrën pjesë dhe përfaqësues nga Qendra UET, si organizata zbatuese e projektit, por dhe përfaqësues nga Fondacioni ABC, apo institucione të tjera partnere si IRCA dhe UET. Ajo që duhet theksuar është diferenca midis dy fokus grupeve. Qëllimisht ishin përzgjedhur dy grupe të komunitetit Rom me tipare thellësisht të dallueshme nga njëri-tjetri. Në fokus grupin e parë të pranishëm ishin anëtarët aktiv të këtij komuniteti, ndërsa në takimin e dytë, biseda u zhvillua me pjesën më të skajuar të tyre. Kjo përzgjedhje e qëllimshme u realizua për të parë jo vetëm perceptimet dhe nevojat që shfaqin Romët aktiv, por dhe pjesa tjetër, mundësitë e së cilës, përgjithësisht, janë më të pakta për t'u përfshirë në forma të tilla integrale. Ky konstatim u konfirmua gjatë zhvillimit të fokus grupit të dytë, ku ata vetë pohuan se ishte hera e parë që merrnin pjesë në një organizim të tillë. Pozitive, mund të konsiderohet fakti se një pjesë e tyre, pasi u njohën me projektin shfaqën interes të lartë, për t'u përfshirë në projekt dhe për t'u bërë pjesë aktive e formave të ndryshme organizative që krijojnë anëtarët aktiv të komunitetit Rom. Ky fokus grup, shërbeu dhe si hapi i parë për krijimin e një rrjeti më të gjerë mes komunitetit. Krahas fokus grupeve u realizuan edhe intervista të thelluara me përfaqësues të shoqërisë civile të komunitetit Rom për të mbledhur sugjerime rreth zhvillimit të kompetencave mediatike të të rinjve rom. Çështjet kryesore që u ngritën për diskutim, me të dy fokus grupet, lidheshim kryesisht me problematikën e medias masive në lidhje me

komunitetit Rom, përdorimin e mediave të reja apo alternative nga ky komunitet si dhe mbi gjetjen e mënyrave më efikase, të cilat mund të ofrojnë zgjidhje për çështjet problematike të këtij komuniteti. Pas analizimit të të dhënave që na ofruan të dy fokus grupet dhe intervistat e thelluara u evidenua se komuniteti Rom ka hasur disa problematika në lidhje me median massive në Shqipëri. Sipas tyre këto problematika konsistojnë në:

- Komuniteti Rom zë një hapësirë shumë të vogël në këto media, pra ka mospërfaqësim të tyre në një shkallë të gjerë;
- Mungesa e rolit aktiv të mediave për të pasqyruar vlerat, kulturën apo gjuhën e komunitetit;
- Lajmet që shfaqen për këtë Komunitet janë përgjithësisht me ngjyrim negative;
- Mungesa e frymës së multikulturalizmit te gazetarët, kjo i bën të panjohur me çështjet e Romëve dhe ndikon në rutinën e krijimit/pasqyrimin të lajmit;
- Mediat janë paragjykuese;
- Mos trajtimi nga media i çështjes Rome si pjesë integrale e shoqërisë, por si një pjesë e izoluar e saj;
- Në median masive mungon analiza e thellë e bazuar në evidenca, kërkim shkencor apo krahasim perspektivash të ndryshme.

Gjatë diskutimit një hapësirë tjetër zuri dhe evidentimi i formave të reja të komunikimit që ofrohen sot, siç janë mediat alternative sipas përkufizimit në seksionin e dytë të këtij dokumenti. Këto median përdoren gjerësisht dhe nga komuniteti Rom, si një mundësi e mirë për të lidhur ura komunikimi dhe për të realizuar disa nga objektivat e tyre. Tiparet kryesore të këtyre mediave alternative në avantazh të komunitetit Rom si grup i skajuar vijnë si më poshtë:

- përdorimi i tyre si mundësia më e mirë për t'u informuar dhe për t'ju kundërvënë izolimit mediatik që ofrojnë mediat e mëdha;

- media alternative si mundësi për prodhimin e produkteve mediatike nga vetë komuniteti Rom;
- media alternative për të shpërndarë lehtësisht lajmin që ata duan t'a ndajnë dhe me pjesën tjetër të shoqërisë;
- mediat alternative si mundësi për të rritur dhe zhvilluar më tej aktivitetet e ndërmarra nga komuniteti rom pa kosto (si forma që shërben për të shpërndarë lajmin, në rastin e Romëve që kanë ngritur një aktivitet privat dhe dëshirojnë t'a ngrënë në nivele më të larta punën e tyre).

Por, krahas evidentimit të problematikave që shfaq media masive në Shqipëri dhe rolit që kanë filluar të luajnë mediat alternative, gjatë diskutimit u hodhën dhe disa ide në lidhje me zgjidhjen e kësaj situate duke përdorur jo vetëm median masive, por kryesisht mediat alternative: Dimensionet që japin për zgjidhje sipas komunitetit Rom, si më poshtë:

- realizimi i një lajmi tërheqës mbi komunitetin Rom, përputhja e tij me trendet e ditës;
- romët të diskutojnë për çështje që prekin të gjithë shoqërinë Shqipëtare si pjesë integrale e shoqërisë dhe jo si pakicë dhe këto diskutime duhet t'i shfaqin në median që ata kanë më tepër akses, siç është media alternative;
- duke qënë se media është dhe një institucion biznesi, atëherë lajmet që ofrojnë duhet të jenë dhe sensacionale, por lajme me ngjyime pozitive, në këtë mënyrë do të kenë dhe interesin e medias, por dhe të pjesës tjetër të shoqërisë;
- zhvillimi i praktikave për të krijuar një rrejt me gazetarë, në mënyrë që të jenë më prezent në emisionet e tyre televizive;
- pasqyrimi i eventeve të tyre nëpërmjet rubrikave të posaçme në median e shkruar;
- krijimi i fushave të advokimit online;
- krijimi dhe ngritja e një Radio nga Komuniteti Rom si mundësia më e mirë për t'u informuar dhe ajo pjesë e komunitetit që nuk ka akses në internet;

- ndërthurja e marrjes së informacionit online me median tradicionale, siç është printimi dhe shpërndarja, si forma që vjen në përputhje me nevojat dhe karakteristikat që ka grupi tek i cili po adreson lajmet

REKOMANDIME

Nisur nga të dhënat cilësore të mbledhura nga fokus grupet dhe intervistat e thelluara si edhe nga analiza e literaturës disa rekomandime lidhur me krijimin e hapësirave komunikuese alternative dhe pjesëmarrëse për komunitetin Rom në Shqipëri janë:

- Përfshirja në kurrikula akademike në institucionet e arsimit të lartë e lëndës: Media për ndryshim shoqëror për programet e shkencave sociale si edhe komunikimit, gazetarisë dhe punës sociale në nënyrë që profesionistët e rinj si psh gazetarët apo punonjësit e ardhshëm social të njihen me rëndësinë dhe mënyrat sesi media mund të zhvillohet kah qëllimeve të ndryshimeve shoqërore sikurse gjithëpërfshirja dhe lufta ndaj diskriminimit;
- Përfshirja në kurrikula në arsimin e mesëm dhe të lartë e rasteve studimore dhe nxënies përmes projekteve të përqëndruara tek media për ndryshim shoqëror, mediat e reja dhe ato alternative;
- Përdorimi i mediave të reja, alternative, sociale nga komuniteti dhe aktivistë të tjerë për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve, politikëbërësve dhe aktorëve të tjerë rreth kauzave të gjithëpërfshirjes dhe luftës ndaj diskriminimit përmes ndërtimit të komuniteteve online; fushatave online dhe offline si edhe llojit të përmbajtjes;
- Organizatat e shoqërisë civile, përmes mbështetjes financiare nga qeveria apo donatorë kombëtarë e ndërkombëtarë, duhet të ofrojnë trajnime për ndërtimin e kapaciteteve për përdorimin e mediave

të reja dhe alternative për të siguruar ndryshim shoqëror; trajnimet duhet të përqendrohen në komunitetet dhe në bazë të nevojave të komunitetit në rajone të ndryshme të vendit dhe jo ekskluzivisht në Tiranë;

- Vëmendje duhet përqendruar tek medime komunikimi specifik të cilët përdoren më shumë dhe janë më të aksesueshëm nga komuniteti rom si psh radio dhe 'smart phones' si dhe mundësitë që ofrojnë këto medime për hapësira komunikuese alternative dhe pjesëmarrëse, psh një radio e komunitetit online apo fushata inspiruese të përshtatshme për rrjetet sociale online apo aplikacione që lehtësojnë ndërveprimin mes kulturave dhe grupeve

të ndryshme në shoqëri;

- Inkurajimi dhe mbështetja e mediave masive dhe konvencionale që të zhvillojnë trajnime profesionale për gazetarët lidhur me pasqyrimin e komuniteteve të skajuar në media; rishikimi i kodit të etikës dhe praktikave të punës së gazetarëve profesionist;
- Mbështetja dhe fuqizimi i iniciativave ekzistuese dhe të reja të komunitetit për të ndërtuar mediumet e tyre të komunikimit si nga organizatat jo qeveritare, institucionet e arsimit të lartë; institucionet qeveritare dhe aktorë ndërkombëtare me kujdesin e shmangies së vetë-izolimit të komunitetit dhe përforcimit të ndërlidhjeve me grupet e tjera shoqërore.

KONFERENCË



Fuqizimi i të rinjve rom përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe edukimit për median alternative

Dt. 27 maj 2015, ora 14:00-16:00, Auditori Aula Magna




ALBANIAN
BESA
CAPITAL



Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



info@uet.edu.al www.uet.edu.al



UET CENTRE / QENDRA UET

